REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 24.12.2025 Prot.47 (dyzetëeshtatë)

Protokoll nr. 47

I mbajtur sot më datë 24.12.2025, në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 31.10.2025 dhe 26.11.2025.
4.P-V "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet për shkeljet apo kundravajtjet administrative për vitin 2026";
5.P-V "Për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të adminsitratës së Bashkisë Maliq dhe struktura të tjera për vitin 2026";
6.P-V "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2026";
7.P-V"Për miratimin e listës të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin 2026";
8.P-V "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për vitet 2026-2028 ";
9.P-V "Për miratimin e kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe vjetor 2026";
10.P-V "Për miratimin e bursave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional të vitit shkollor 2025-2026";
11. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin nëntor 2025";
12.P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
13. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.G.B banues në fashtin Zvirinë NJ.A Pirg, banesa e të cilit u shemb si pasojë e përmbytjes së datës 20.11.2025";
14.Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Floreta Zaçe; Marainathi Avrami; Idlir Limllari; Klea Baçi;Pranvera Begolli; Gentiana Drabo; Petrit Kupe; Aramando Dautllari; Danjela Ibrahim; Fevri Sherifi; Plator Çollaku; Ilia Xhuti; Xhuana Hoxhallari; Rovena Terolli; Enida Avdolli; Dalina Krekas;Almir Elezi; Andonaq Risto; Faslli Zholi; Neresida Shindo; Marjeta Xhelollari; Albina Xhejo; Yllson Ibrahimllari; Lulëzim Hoxhaj; Server Xhuti; 29(njëzetëenëntë) këshilltarë.

Mungesa: Eriseld Jonusllari; Eglantina Balli;2 (dy).

Të pranishëm nga Administrata: Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu; Sekretare Përgjithshme: znj.Jonila Xhihalli; Drejtore e Financës dhe Buxhetit:Almira Muka; Punonjëse e Shërbimit Social:znj.Johana Lami; Specialist i Zyrës të Arsimit në bashki; Florenc Muçollari; Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë të Ardhurave:znj.Alma Shkëlqmi; Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike; Eridjon Rustemi; Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile; z.Stiljan Belishta; Adminstratorët e Njësive Bashiake; znj.Rudina Bregu; z.Ronaldo Skënderi; z.Kejdi Hasani; z.Eleni Mina; z.Mikel Adri.

Ornildi Demollari:Mirë, ju lutem zini vend e të fillojmë. Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit që merrni pjesë në këtë mbledhje. Të nderuar kolegë shqiptarë, i nderuar kryetarë, të nderuar pjesëmarrës. Fillojmë me mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë Maliqit, sikurse jeni njoftuar. Është mbledhja e fundit e vitit, një nga mbledhjet më të rëndësishme. Të këtij institucioni, pasi në këtë në këtë mbledhje miratohen një sërë dokumentash që janë shumë të rëndësishme për bashkinë, për institucionin e bashkisë, siç është buxheti, Paketa fiskale, bursat dhe disa dokumenta të tjera. Së pari, dua t'i falenderoj të gjithë ata që kanë punuar për pregatitjen e buxhetit. Dhe shpresoj që të jetë një buxhet që të vijë sa më pranë nevojave dhe dëshirave të qytetarëve në vitin e ardhshëm. Sikundër dua t'i uroj punë të mbarë dhe të gjithë atyre të cilët do të punojnë për zbatimin e tij gjatë gjithë vitit. Përpara se të fillojmë, verifikojmë korumin. Korumi realizohet pasi nga apeli që ne bëmë. Janë rreth njëzet e tetë këshilltarë në sallë, kështu që mund të vijojmë. Dhe ju ftoj të miratojmë rendin e ditës?
Kush është dakord me rendin e ditës? 27 vota pro.
Kundër? 1 votë kundra.Yllson Ibarahimllari.
Abstenim.Nuk ka. Me njëzet e shtatë vota pro dhe një kundër miratohet rendi ditës, kështu që mund të vijojmë. Më lejoni t'ju njoh me vendimet e mbledhjes së kaluar, të cilat janë tetë gjithsej tetë vendime, pesë me karakter normative, të cilat kanë marrë dakordësinë e institucionit të prefekturës dhe tre me karakter kolektiv janë tetë gjithsej, të cilat janë kthyer në vendime. Ju ftoj të miratojmë protokollin e mbledhjes të datës 31.10.2025.Të cilin e kemi të prapambetur, nuk e kemi miratuar. Kush është dakord me protokollin e mbledhjes? 28 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet protokolli i mbledhjes së datës tridhjetë tetor. Ju ftoj të miratojmë edhe protokollin e mbledhjes së datës njëzet e gjashtë nëntor, pasi e kishim edhe këtë.
Kush është dakord kundër? 28 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim.Nuk ka.Miratohet edhe protokolli i mbledhjes së nëntorit. Dhe tani, sipas rendit të ditës, kalojmë tek pika katër, që është miratimi i projektvendim më falni për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Maliq, penalitetet, për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem. Deklarova votën time kundër rendit të ditës. Arsyetimi është që në të gjitha seminaret, konsultimet, bazën ligjore të theksuar në të gjitha përgatitjet në daljet tuaja

dhe të kryesisë në Facebook. Besoj që është e logjikshme që asnjë në rendin e ditës nuk do të kalojë asnjë nga pikat e cila nuk ka relacion përkatës nga komisionet e këshillit. Arsyeja është që nëse ekzekutivi vjen dhe harxhon kohën, shtabi që ka ngritur struktura strategjike për të bërë buxhetin. Ne nuk na vihet asnjëherë në asnjë mbledhje të këshillit një relacion paraprak i grupeve dhe komisioneve të këshillit. Nuk jemi atje ku kemi qenë. Por kemi shumë punë për të bërë, nuk do kalojmë në asnjë rendite. Ju keni kartonat, mund ta bëni? Në asnjë renditje, asnjë projekt vendimi, i cili nuk ka relacion nga komisionet përkatëse, e thotë ligji, e thotë rregullorja. Nuk mund të mblidhet komisioni i buxhetit i financave një ditë përpara mbledhjes së këshillit, sepse i bie që stafin strategjik që ka kryetari i bashkisë. Në të gjitha vërejtjet që mund të bëjë ky komision, nuk ka kohë fizike të reflektojë dhe t'i sjellë një buxhet për të qenë këtij këshilli. Nëse do të vijnë për të bërë procedura formale, të vazhdojmë. Ju faleminderit. Dua që pikat që janë në rendin e ditës të kenë paraprakisht relacionet përkatëse të komisioneve të këshillit.

Ornildi Demollari:Faleminderit koleg. Tani, të paktën për këtë mbledhje, komisionet u mblodhën. Ai shqetësim që ne kishim, se komisionet nuk mblidheshin, të paktën u mblodhën në dijeninë time disa nga komisionet. Megjithatë, faleminderit për sugjerimet që dhe jemi tek pika katër.

Faslli Zholi: Përshëndetje të gjithëve, përsa i përket komisioneve, doktori ka të drejtë që relacionet duhet të bëhen, kurse dije komisionet kanë funksionuar me llaf më the me shtatëdhjetë tetëdhjetë për qind. Nga ajo që ishte për këtë, i përgëzoj të gjithë ata që relacioni është e drejtë që duhet bërë. Faleminderit.

Yllson Ibrahimllari: Të këshillit të njihemi dhe të vazhdojmë të reflektojmë. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Jemi tek pika katër, e lutem, komisioni i financës. Keni diçka apo t'i japim fjalën kryetarit?

Petrit Kupe: Përsa i përket pikës katër, komisioni financë u mblodh dje dhe shqyrtoi duke parë të gjithë, tarifat, taksat, tarifat apo vendosja e gjobave dhe konstatoj që për vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë. Nuk kemi ndryshime të taksave dhe tarifave për bashkinë e Maliqit. Siç dihet, taksa të Bashkinë e Maliqit duke filluar që nga viti dy mijë e pesëmbëdhjetë. Taksa për ndërtesën, taksa për pronën apo taksa për tokën janë nga më të ulëtat. Në krahasim me bashkitë e tjera, të cilat janë ulur në kufirin e ligjshëm deri në minus tridhjetë për qind. Pra, duke e parë këto lloj taksa, duke parë që nuk kanë ndryshime të tyre, ne shprehim dakordësinë që të miratohen këto taksa prej vitit dy mijë e njëzetë e gjashtë. Dhe komisioni, të gjithë anëtarët e komisionit ishin dakord. Përsa i përket komisionit, po një ditë para u mblodhëm, sepse është dhe ditët e pushimeve, por kjo nuk do të thotë që komisioni nuk ishte i pregatitur, edhe për pikat e tjera që kanë bërë me buxhetin apo me strukturën. U diskutua në praninë e kryetarit gjerësisht, edhe për shumë gjëra të tjera të cilat do t'i themi mposhtë. U ra dakord të bëhen ndryshime përkatëse për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Këto kishin pikën katër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA MALIQ

Ornildi Demollari: Po, faleminderit, kryetar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje e të gjithëve të nderuar këshilltarë, të nderuar qytetarë. Kjo është, besoj, mbledhja më e rëndësishme e një institucioni. Pra, dhe e bashkisë tonë, pasi në këtë mbledhje miratohet buxheti për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Në materialin që ne ju kemi prezantuar, parashtrojmë ato objektiva, ato strategji të cilat ne synojmë t'i arrijmë. Patjetër është një buxhet ambicioz, i cili kërkon punë, kërkon angazhim nga të gjithë. Edhe unë dua ta falenderoj edhe këshillën e bashkisë, i cili rast pas rasti me vendimarrjet e veta ka rregulluar dhe ka përmirësuar. Dhe ka mbështetur punën tonë të përditshme, për efekt të realizimit sa më shumë shërbimeve dhe investimeve në territor, pikë e parë për të cilën flasim ka të bëjë me paketën fiskale. Siç e përmëndi edhe Petriti në emër të Komisionit të Financës, nuk ka ndryshime rrënjësore. Jemi munduar të ruajmë një nivel taksash, të pranueshme për komunitetin që përfaqësojmë, për zonat që përfaqësojmë, edhe pse unë mendoj që në disa pika. Ai duhet rishikuar, duhet përmirësuar për efekt të përmirësimit të shërbimeve në territor. Një nga ato mund të jetë tarifa e pastrimit, e cila jo se nuk realizohet nga ana jonë, por përsëri duhet që pjesa e fondeve që grumbullohen për efekt të këtij shërbimit duhet t'i përafrohet kostos reale të shërbimit në territor, po të marrim në konsideratë edhe atë çfarë ne mund të jemi nga qarqet e vetëm, që kemi një lëndëfill funksional me efektivitet. Ku nuk hedhim tani mbetje vend e pa vend, edhe pse në zona në periferi, në zona të caktuara ka ndotje të territorit dhe kjo kërkon ndërgjegjësim, këto kërkon një kulturë të përgjithshme, kërkon masa administrative, patjetër. Por në fund të fundit, ne duhet të synojmë më të mirën e mundshme për komunitetet tona. Siç e thashë, paketa fiskale nuk ka ndryshime rrënjësore në vetvete. Ne ju kemi prezantuar komplet paketën. Telegrafisht po ju përmend disa përjashtime që kjo paketë përjashtohet nga taksa e tokës bujqësore, ata që mbledhin mbjellin pemëtari, vreshtari dhe pesë vitet e para. Ligji e parashikon që nuk paguajnë asnjë lloj takse, përjashtojnë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë. Në investime që kanë të bëjnë me agroturizmin, me riparim-restaurim ndërtesash, që kanë të bëjnë në lidhje me mbrojtjen civile, shumë të rëndësishme. Përjashtim nga tarifat vendore bizneset, të cilat administrohen nga gratë kryeframiljare, reduktojnë 30% bizneset e reja të hapura rishtas nga të rinjtë në moshë 18 deri 25 vjet. Familje që trajtojnë mendime ekonomike, kategoritë pensionistë të vetmuar, përjashtohen tarifa e pastrimit, ndriçim dhe gjelbërim për të gjitha familjet. në territore të zonave malore, të cilat ne nuk kryejmë një shërbim të tillë. Gratë kryefamiljare që nuk janë në marrëdhënie pune përjashtojnë nga pagesa e tarifave vendore, përjashtojnë nga tarifa e gjelbërimit të familjet e fshatrave ku nuk afrohet ky shërbim në të gjithë pjesën malore të bashkisë. Përjashtohet nga tarifa e pastrimit të gjithë banorët e fshatrave, ku nuk kemi një shërbim direkt me ne, me mjete me punëtorë e tjera, edhe pse nuk është se këtu mungon shërbimi i pastrimit po kryhet në mënyrë periodike, një herë në dy javë, një herë në muaj, duke i grumbulluar, duke i sistemuar. E njëjta gjë ndodh edhe për tarifën e ndriçimit në zona të cilat nuk kanë ndriçim publik, megjithëse ne po synojmë që ta përmirësojmë edhe në zona, edhe pse mund të ketë zona malore të cilat mund të ketë pak shpi dhe më shumë koston rrjeti elektrik për ta bërë të kontrolluar, po mundohemi ta bëjmë me ndriçim fotovoltaik, ku nuk kërkon shpenzime ekstra. Dhe kemi filluar që nga ky vit, jemi në atë fazë të shpërndarjes së këtyre ndriçuesve. Të aplikohet një ulje dhjetë për qind e tarifave vendore për të gjithë familjarët apo çdo subjekt

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

debitor, i cili i shlyen gjithë detyrimet për taksa dhe tarifa vendore të prapambetura në një klasë të vet, domethënë i kemi propozuar këshillit edhe një masë të tillë, që në qoftë se ka detyrime të prapambetura ndër vite. Gjithë kjo ulet me dhjetë për qind në qoftë se ata i shlyejnë. Gjithë detyrimin menjëherë, përjashtoj nga taksa e ndërtesës, pronat e shtetit, pasuritë në pronësi të shtetit të kaluar në vendin e këshillit për shoqëritë publike. Ndërtesat e banimit shfrytëzohen nga qiramarrësit dhe qira të paliberalizuar, edhe pse ne kemi pak, mos thënë zero. Banesa sociale në pronësi të bashkive, pasuritë e paluajtshme ndërtesë, që janë persona juridikë fizikë në marrëdhënie me bashkinë dhe që përdoren nga këta të fundit për banesa sociale. Ndërtesa që përdoren nga komunitete fetare, ndërtesa banimi të deklaruara për vendbanim kryefamiljar, që përfitojnë pension pleqërie. Domethënë, janë disa përjashtime të cilat disa i parashikon ligji, disa ne na jep të drejtën për t'ia propozuar. Ndryshimi i paketës fiskale dy mijë e dy mijë e njëzet e pesë kemi ndryshuar disa tarifa në lidhje me linjat ajrore të kabllorëve të transmetimit internet. Kemi bërë një ulje nga dyqind mijë lekë në njëqind mijë lekë në vit. Sipas zonave, njëqind e pesëdhjetë njëqind dhe Gora Moglis nga pesëdhjetë e njëqind e pesëdhjetë mijë lekë në vit. Tarifa përjashtimi kanë edhe zona të cilat janë zona malore për efekt të gjelbërimit, si të thashë pak më lartë, të ndriçimit. Mirëmbajtjes së kanaleve kulluese, po për zonat malore ku nuk ka një shërbim të tillë nga ana jonë. Kemi bërë, kemi rifutur këtë vit edhe përjashtimin për familjet jo rezidente në territor. Përjashtohen e kemi patur, e kemi futur pasi ka patur një debat në lidhje me këtë pikë, po ia propozojmë përsëri, për t'u përjashtuar nga tarifa e pastrimit, e ndriçimit dhe e gjelbërimit, jo tarifa e virgjisë. Ajo është detyrim se shpinë e kanë të gjithë. Të cilët nuk jetojnë në territor për një afat minimumi gjashtë muaj dhe këtë e vërtetojnë me dokumenta. Që mund të jenë pasaporta për jashtë shtetit që e vërteton, apo edhe dokument nga administratorët apo kryetarët e fshatrave, të cilët e vërtetojnë po me dokumenta. Këto ishin ato çfarë ne kemi ndryshuar. Ju kemi prezantuar një buxhet, i cili për efekt të ndryshimit të ligjit për Taksa mbi ndërtesat ka një rritje në total prej 20 milionë lekë, e cila e jep efektin pastaj edhe në buxhetin e përgjithshëm. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit zoti kryetar, pasi unë kisha gjetë në këtë pyetje.

Faslli Zholi: Së pari, e dëgjova kryetarin. Do të bëj një pyetje, sa për qind kemi ne në bashkinë tonë që operojnë biznese private, bankat toka, dhe sa janë na këta që nuk kanë shlyer detyrimet e taksave? Sepse jemi dhënë pra këtë miratimit sot të buxhetit dhe kështu do të vijë edhe buxheti që të pasurohet dhe të shërbehet pastaj më tej. E para, sa për qind është? E kam fjalën që nuk i paguajnë, dhe e dyta, na këta që nuk i paguajnë. E kanë nënvlerësuar dhe s'duan të paguajë. Kemi një diçka të kësaj kohe? Apo nuk kanë të ardhura dhe nuk arrijnë dot që t'i ndahemi gjërat? Ku janë? Faleminderit.

Ornildi Demollari: Atëherë kemi ndonjë pyetje tjetër përpara se ta.

Almir Elezi: Ju merrni taksë gjelbërimi edhe nëpër bizneset në Podgorie, por këtë. Nuk ju nuk e ofroni gjërbërimin në Podgorie ose nëpër fshatra të tjera, si i bëhet kësaj rast.Ju marrim takt, nuk ofrojmë shërbimin.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi ndonjë pyetje tjetër përpara se ta?

Yllson Ibrahimllari: Ka një sugjerim. Besoj që edhe banorët jo rezidencë të këtij qyteti apo të kësaj bashkie duhet të mos shmangen nga taksa që kanë. Është një kontribut që bën për vendlindjen në fund të fundit, se të gjithë vijnë edhe e kritikojnë kryetarin. Pse s'është e pastruar? Pse qentë rrotullohen rreth kombinatit? Pse s'kemi vende parkingjesh? Është një taksë simbolike, e cila nuk ka pse t'i shmangia ata nëse në diku tjetër nuk e paguajnë këtë taksë. Pra, nëse dikush e paguan Tiranë, s'ka pse ta paguajnë më Maliq. Por banorët që janë jashtë shtetit, le ta kenë si kontribut për vendlindjen e tyre. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Kemi ndonjë pyetje tjetër ose sugjerim? Faleminderit, kryetar, të lutem në lidhje me të.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Në lidhje me detyrimet e prapambetura të biznesit, ky nivel shkon në nivele dhjetë për qind. Janë bizneset më problematike që ne kemi në territorin e bashkisë. Sapo kemi filluar bllokimin e të gjitha llogarive, edhe mungesën e shërbimeve në Drejtorinë e Transportit, siç parashikon ligji. Dhe shkojmë pastaj në ekstrem deri në konfiskim të mallrave. I gjithë korrespondenca është zyrtare. Na detyron ligji për ta zbatuar dhe ndiqemi as pas hapi, jo me fjalë, por me shkresa. Kështu që unë besoj dhe shpresoj që të gjithë të arrijmë maksimumin e mundshëm. Nuk besoj që këto biznese kanë pamundësinë për të paguar, por për efekt problematikës që ata hiqen në zona të caktuara, bëhen problem për të gjithë ne. Por në fund të fundit, ne nuk kemi se në momentin e caktuar ne kërkojmë një deklaratë të tyre, një apelim ndaj tyre, në qoftë se taksat apo tarifat janë mbi nivelin që ata mund ta përballojnë vetë, megjithëse ne, po ta shikoni, i kemi ndarë. Në tarifa të tilla që në një farë mënyre janë shumë shumë të përballueshme për të gjithë territorin. Po të bëjmë një krahasim, nuk e di kush e tha ajo, tha Petriti pak më parë. Bashkia jonë mund të ketë nivelin e taksave dhe tarifa më të ulët në të gjithë Shqipërinë. Kjo për shumë arsye, por edhe për vetë. Atë momentin social, i cili ne mendojmë që janë zona të cilat nuk kanë një efektivitet shumë të madh në biznes. Apo në prodhimet e tyre bujqësore blegtorale, ndaj edhe kemi parë në këtë sy. A ka ardhur momenti të rishikojmë disa prej tyre? Ndoshta po, dhe kjo me të vetmin qëllim për të përmirësuar, siç e thashë, shërbimet ndaj tyre, ndaj komunitetit. Në lidhje me atë që doktori me të drejtë tha, ajo lë moment për diskutim. Hajde ta rishikojmë, hajde ta shikojmë. Në qoftë se e vendosim që po do t'ia vlejmë të gjithëve për këtë të përgjithshme, që edhe ata të kontribuojnë pasi edhe ata kanë detyrime dhe nuk besoj se kjo taksë është kaq e madhe sa ata. Mos e mos kontribuojnë, por unë do isha shumë dakord dhe s'kam asnjë mëdyshje që si ta vendosim bashkërisht në lidhje me pyetjen për pagesën e gjelbërimit. Po ta shikoni, Almir, këto tarifa janë shumë të ulta. Mund të jenë po them qind lekë, qind e njëzet lekë janë tarifa të cilat nuk nënkuptojnë që ne po bëjmë lulishte në çdo fshat. Se është nonsens, por ne synojmë që të mbjellim pemë në oborret e shkollave, të mbjellim pemë në zona që kanë rrëshqitje, të mbjellim pemë në rruga nacionale. Pse mos të bëjmë ndonjë lulishte në një oborr shkolle të tjera? Në këtë prizëm është parë, është një praktikë e të gjithëve. Nuk janë tarifa shumë të mëdha që ne, edhe bizneset, po të paguajnë pesë mijë lekë në vit. Në kuptimin që edhe ata të kontribuojnë për përmirësimin e situatës në

territor, në këtë prizëm është parë a ka vend kjo për debatim. Besoj se ka. Se derisa paguajnë, shikohet në prizmin që edhe ata duhet të marrin pjesën e tyre të kontributit për këtë zë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, atëherë kalojmë në votim pikën katër. Lutem, kush është dakord?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Sa propozimi që ju do të thotë të të shikojë në qoftë se këshilltarët mendojnë që duhet ta votoni siç e kemi sjellë ne, ose në qoftë se doni ta ndryshoni, është e drejta juaj.

Yllson Ibrahimllari: Ju lutem, një argument në një kombje kosovarët kontribuojnë dhe çliruan Kosovën. Ne nuk po bëjmë dot Maliqin të banueshëm. Tani të lutem, ne kemi gjysmën e njerëzve nëpër fshatra, kanë ikur, jetojnë në Greqi, në Australi, në Amerikë. Ky është një kontribut që vjen për qytetin e Maliqit. Këta këtyre që kemi në malësi, thotë që i kemi taksat e ulëta, se janë pa zhvillim dhe s'kemi ça t'ju marrim. Unë që vij si emigrant këtu, se ju më bëni shërbim te bashkia kur vij për kërkoj diçka. Përderisa jam rezident, unë nuk duhet të paguaj asgjë. Tani ju lutem.Unë nuk kam asnjë gjë me bindjet tuaja politike. Unë jam i gjatë dhe unë kam taksa. Më vjen keq zotni.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ky është një kontribut që pak nga pak e merr gjithë komuniteti, gjithë zona, dhe nuk besoj, dhe jam në një mendje. Ka patur debat edhe vjet, edhe sivjet. Dhe hyj në linjë në qoftë se bashkërisht biem dakord që të përfshihen të gjithë. Është shumë shumë shumë okej, ndaj edhe.

Faslli Zholi: Unë jam dakord me mendimin e doktorit dhe që po diskutohet. E di pse duhet thënë një diçka e vërtetë. Ne na kapin shumë njerëz që edhe në pallat, që bëni dhe çatira të shpive të që na u pikon pallati. Po duhet të kontribuojnë kushdo, edhe ajo që nuk ka, është se janë tre. Është pallati dhjetëkatësh, supozohet tre hyrje. Dy janë në Greqi apo në Itali, janë jashtë. Tashi ai pallati do pastrohet, do mbahet.

Yllson Ibrahimllari: Faslli ka them Faik Konica, unë e bëj Shqipërinë, Austri dhe po ku t'i gjej vienezët. Tani po themi, një prova kundër ata.

Faslli Zholi:E jam pro që ta miratojmë këtë, që të jeni kontribut. Sado i vogël e të jetë, që të vijë në ndihmë, se dritë kërkon edhe ajo që është jashtë, edhe ajo që është këtu.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë do isha shumë dakord që ta miratoj me këtë ndryshim të fundit që propozoj.

Ornildi Demollari: Po, po, ta hedhim si ju lutem e kalojmë votim?Kush është dakord? Me ndryshimin patjetër.29 vota pro.Kundër? Nuk ka.Abstenim nuk.Miratohet. Me njëzet e nëntë vota pro miratohet pika katër. Faleminderit. Shkojmë tek pika pesë e rendit të ditës, që është.

Projekt vendim për miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë Mali dhe strukturat e tjera për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Pra, struktura.

Petrit Kupe: Komisioni i financës, ashtu siç e kemi shprehur edhe në takimin e Komisionit të Financës. Struktura u pa në dy drejtime. Ky pretendim u pa në dy drejtime në strukturën dhe në nivelin e parë. Konstatuam që për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë do kemi ndryshime të strukturës në krahasim me dy mijë e njëzet e pesën. Kjo për shkak të mosfunksionimit rezultativ të Agjensisë së Shërbimeve, u kthyem në një strukturë të re në ndarje sektoriale. Do të ishte më e qartë edhe për opinionin që të kishin një organogram të strukturës për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. për të parë edhe varësinë direkte të sektorëve të krijuar apo të drejtorive të krijuar. E veçantë këtë vit është krijimi i Drejtorisë të Kulturës. Kjo për shkak sepse do të marrë jetë, besoj, aktiviteti në Kinoklubin e ringritur. Dhe të tjerat janë në nivel sektorësh. Përsa i përket kësaj strukture, e cila shpreh mënyrën e organizimit dhe drejtimit të punëve për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, ne jemi dakord, si komision që ta miratojmë, mbase edhe elitë e numrit të punonjësve nuk kanë krahasim me dy mijë e njëzet e pesë. Dhe kjo t'i shërbejë funksionimit më të mirë të punëve në vitin e ardhshëm. Personalisht, do të kisha një sugjerim për krijimin e një drejtorie, duke patur parasysh edhe natyrën e bashkisë të Maliqit, një bashki që ka drejtim kryesor bujqësinë dhe blegtorinë apo pemëtarinë, për mua do të ishte e mirë të ishte bujqësia në një nivel drejtorie, ku të përfshihej bordi i kullimit, të përfshihej pyjorja apo edhe mbrojtja e konsumatorit. Ky është sugjerimi im personal. Ndoshta momenti, kryetari nuk e di si të argumentohet, por do të ishte më mirë të funksiononte kështu. Sepse po krijojmë një drejtori shumë mirë për kulturën. Por bujqësia, që është drejtimi kryesor, do ta kishte një vëmendje të tillë përsa i përket pagave. Ajo që konstatojmë është rritja e konsiderueshme e pagës minimale, e quaj të konsiderueshme mbasi përfshin një numër të madh të punonjësve në Bashkinë e Maliqit. E cila arrin në pesëdhjetë mijë lekë edhe ka shumë pak lëvizje të tjera të pagave në strukturën ekzistuese, disa rregullime të pjesore nga ana e bashkisë. Rritja e konsiderueshme e pagës, mendoj, është kuptohet pozitive, po brenda, mendoj unë, brenda nivelit të pagës 50 mijë lekë. Ka ardhur momenti që do të bëhen disa ndryshime në specialitete, sepse në pagën pesëqind mijë lekë përfshihet edhe ai që ka arsimin tetëvjeçar edhe ai që ka arsimit të mesëm, po përfshihet edhe ai që është specialist, siç është hidraulik, litriçist, etjera, etjera. Kështu që ashtu siç biseduam dje në komision, kryetari ra dakord që këto diferencime të bëhen. Të bëhen për të ruajtur raportin dhe për të funksionuar të mos i barazuar në të gjithë punonjësit me pagën pesëqind mië lekë. Rritja e pagës minimale bëri që të ngushtohen dallimet midis pagave të tjera. Kështu që paga minimale afrohet rreth një punonjësi që është me arsim të lartë në tatim taksat. Po afrohet, jo se barazohet. Kështu që ky afrimitet kërkon që të bëhet përsëri të ruhet ky proporcionalitet midis punonjësve me arsim të mesëm dhe atyre që janë me paga me rastim të mesëm. Edhe për këtë, po folëm dije me kryetarin e krijoi këtë problem rritja e pagës minimale, por ramë dakord që të bëhet përsëri ky diferencim, ndoshta edhe që në takimin e sotëm, në qoftë se prisnim një, kështu është kryetar, një fond të konsiderueshëm për shlyerjen e detyrimeve të vitit dy mijë e njëzet e pesë dhe një pjesë për fondin e pagave. Këto ishin kryesisht të paga, pastaj aty në komision u diskutua edhe problemi i mosbarazisë të pagave në nivele të barabarta ngarkese përgjesa sektori. Por ajo që është duhet ta kuptojnë të gjithë ata që janë, apo jo pëtjgegjës sektori. Pagat nuk kanë pse të jenë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA MALIQ

të barabarta, sepse edhe kontributi i gjithë përgjegjësave të sektorit nuk është i barabartë në aktivitetin e. Kështu që është pranuar edhe një farë diferencimi të pagave të përgjithshme të sektorëve pra, përgjithësisht ne jemi dakord me këtë strukturë dhe me këtë nivel pagash, por duke na shpjeguar te kryetari dhe këtë pjesën tjetër që mendoj që do të diskutosh, edhe ndoshta ka ardhur momenti që të miratohet që ditën e sotme, pa bërë një mbledhje tjetër të Këshillit të Bashkisë.

Ornildi Demollari: Petrit, faleminderit, Luli.

Lulëzim Hoxhaj:Përshëndetje dhe bie dakord, me mendimin dhe propozimin që bëri Petriti, që sektori i bujqësisë të mos jetë më në nivelin e sektorit, po të jetë në nivelin e një drejtorie. Ka shumë argumenta për këtë, por me dy fjalë, një drejtim i centralizuar i gjithë aspekteve që kanë të bëjnë me bujqësinë, do të ishte shumë më efikas, unë nuk e di, ndoshta, ndoshta, meqënëse Bashkia e Maliqit ka drejtim bujqësor. Është të duket pak kështu absurde që bujqësia të jetë në nivelin e një sektori, bile bile. Mendoj që është do jetë drejtoria mbi drejtoritë e tjera, do të them një nga drejtoritë kryesore, do jetë drejtoria e bujqësisë. Jam plotësisht dakord me fjalë dhe nuk ka arsye pse mos bëhem. Nuk e di si është gjykuar, por që mendoj që do jetë shumë shumë mirë dhe do jetë shumë efikase duke qenë në sektorin e drejtorisë. Pastaj, pa mohuar fare vlerat edhe sektorëve të tjerë, të themi për shembull që kultura në nivel drejtorie, bujqësia është në nivel sektori. Kjo është pak nonsens mendoj unë. Kështu që jam i mendimit që e mbështeta atë të Kupës, që bujqësia patjetër duhet të jetë në nivelin e një drejtorie.

Ornildi Demollari: Faleminderit, kemi gjë tjetër tek struktura?

Yllson Ibrhhimllari: Po, ju faleminderit. E para në këtë strukturë që na vjen, ne duhet të mësojmë nga e kaluara jonë, jo e largët. Të paktën të kemi një argument, ça nuk funksionoi në atë organizimin e vitit të kaluar, se miratuam një agjensi me goxha argumenta, me goxha debate, me goxha gjërash dhe të paktën kush nuk mëson nga e kaluara, beson që e përsërit në të ardhmen. E dyta, përsa i përket numrit, unë besoj që problemi i kësaj bashkie në tërësi është zemërgjerësia e kryetarit dhe ekipi i pakontrolluar. Do të thotë indeksi i performancës. Të gjithë na vijnë e ankohen se ka rrogat e vogla dhe të gjithë i gjejmë jashtë orarit të punës. Kjo është një problem pastaj. Kush të dojë mund t'ia japë dhe argumenta personale në pjesën tjetër duhet të mësojmë çik edhe nga binjakëzimet që kemi bërë si bashki. Kemi bërë një binjakëzime. Një qytet të Amerikës bëmë edhe një me Ferrari në Itali. Ka një koncept të thjeshtë në vetvete. Kush prodhon më shumë, merr më shumë. Do të thotë ekonomisë kombëtare ose lokale, Moglica dhe Gora i japin shumë më shumë sesa gjithë taksat e Bashkisë së Maliqit. Administratori i Gorës dhe i Moglicës ka rrogën më të ulët në gjithë të tjerët. Liboniku mban peshën më të madhe të qytetarisë, të organizimit, problematikave të tjera. Nuk reflektohet rritje pagë tek administratorja e Libonikut, bile nga pozicioni i punës, e kemi çuar për riedukim, domethënë kemi ulur pagën e kam fjalën, jo në sensin tjetër, si mund ta merrni riedukimin. Problemi qëndron që ka një diskordancë midis nivelit arsimor të punonjësve dhe punonjësve që kanë arsimin e lartë, por kanë diferencë shumë të vogël me ta, sigurisht, pozicioni i punës atë i di vetë kryetari, i di vetë

administratat se si janë bërë, por dua që të ekuivalentohet niveli i specialistit si pagë, me gjithë vështirësitë që ka buxheti. Problematikat e tjera, ju faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit.

Faslli Zholi:Në lidhje me këtë propozimin që u bë, mendoj që ekzekutivi të shikojë mundësinë, sepse më duket si absurde që të jetë drejtori kultura. Ne duam kulturën patjetër, por që Bashkai i Maliqit ka një peshë që ka më shumë bujqësi, blegtori, dhe që kjo, jam dakord, jam dakord që kjo të shikohet mundësia që kjo të bëhet një drejtori. E para, e tha bre, po them që jam dakord me këtë histori. Së dyti, kam një dy pyetje këtu. E para, për këto pagat. Duhet i parë sepse kemi ankesa nga shumë punonjës që na kanë zënë. S'ka rëndësi, po doni dhe emrat i bëjmë me publik, që nuk ka një dakord si në i njëjti pozicion. Dikush merr lekë më shumë dikush që bën atë detyrë, pastaj kryetari mos, jo ky është mjaft kështu këtu. Unë them që të shkoj secili në vendin e vet dhe të paguhet ashtu siç duhet. Dhe së dyti, një pyetje tjetër kam që a kemi neve punonjës nga kjo administratë që neve po miratojmë sot, që punojnë me orë të reduktuar shtatë orë punë?

Yllson Ibrhhimllari: Faleminderit, vetëm një sqarim për kryetarin. Timonin makinën me dy timona e kemi pasur, edhe kur ishit ju edhe kur e di, e di, prandaj desha të sqaroj makinën. Me dy timona e keni pasur, edhe kur keni qenë ju në koalicion, e bëhet me një të sigurt. I kini numrat e kartonave. Tani unë po të them se s'kisha ndërmend sot. Do sillesha shumë mirë për juve. A mund të më thoni buxhetin që parashikoni? Për sekretariatin e këshillit bashkiak dhe numrin e punonjësve, se ai djali nuk e përballon dot vetë. Që të na ecin punët mbarë, faleminderit kryetar. Pastaj diskutojmë si shkoj unë me Fazlliun.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kryetar ke fjalën, apo kemi ndonjë pyetje tjetër rreth strukturës?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Përshëndetje e të gjithëve, edhe një herë në lidhje me strukturën. Kemi pothuajse të njëjtën strukturë, ndoshta me një ulje prej tre personash nga viti i kaluar, nga 630 deri në 627, me gjithë punonjësit e arsimit. që janë rreth njëqind e dhjetë, të cilët janë transfertë sektoriale e deleguar. Edukatorët e kopshteve pastrueset nëpër shkolla, që mbulohen nga Ministria e Arsimit. Për efekt të vendimit të qeverisë për pagën minimale, ne kemi rritur pagën në 50 mijë lekë për të gjithë punonjësit mbështetës në të gjithë bashkinë. Dhe efekti është i konsiderueshëm, edhe pse në buxhet kemi një çelje fondi, siç e kemi deklaruar vetëm për efekt të rritjes së pagave. Kemi bërë disa ndryshime për efekt të bashkimit të agjësisë sipas vendimarrjes të fundit që mori Këshilli i Bashkisë. Argumentet mund të jenë pozitive, negative nga këndvështrimet që ka gjithësecili për të analizuar punën e një strukture, punën e një punonjësi. E në fund të fundit, punën e të gjithë administratës së bashkisë, pasqyrë e kësaj administrate bashkie, patjetër është Kryetari i bashkisë, këshilli i bashkisë, gjithë struktura jonë. Çdokush e kupton, bile çuditërisht ndodh që ndonjëherë kërkoj rritje pagë e ata që janë më të dobët në performancë, dhe kjo është për të çuditur. Është për t'u çuditur në kuptimin të Nuk dëgjova. Po pra, po domethënë, njeriu duhet të bëjë një analizë dhe njeriu duhet të jetë, ju lutem,

njeriu duhet të jetë edhe kërkues ndaj vetes, ti edhe ndaj nesh. Unë jam shumë dakord, bile unë hyjni njerëzit, që edhe mund të grinte me një, mund të grinte me dy, mund të grinte me një strukturë, por në fund të fundit, grindja është deri në një moment dhe pastaj fillon, duhet ta analizojë njeriu, e patjetër unë në gjakftohtësi, për punën dhe për performancën që bën çdo njeri, çfarë bëri sot? Kanë ardhur nga ata punojnë, siç u kanë zënë edhe ju. Ju takojnë dhe ju zënë, dhe më tha, shikojnë që pagën time. Grindem gjithmonë me Pranverën. Dhe kur më vijnë, i them po, do ta shikoj. Mund të vish nesër e të më thuash çfarë ke bërë këtë muaj. Në një letër, telegrafisht, po thashë, po flas për punonjësit e administratës, po kjo ndodh edhe për punonjësit, pastruese në një shkollë, ku di unë rojen. Të gjithë punonjësit që ne kemi në territor nuk ka ardhur më, nuk ka ardhur më jo, pse ai nuk punon, por punon edhe ndoshta jo pak që ai merr. Ne duhet ta vëmë në punë dhe ai duhet ta promovojë veten e tij që të arrijë në maksimumin e mundshëm. Të gjithë, por kjo nuk mund të bëhet. Nuk mund të bëhet me të çmuar çdo ditë, kjo ndaj ka struktura dhe përgjegjës çdo strukturë që ata të vënë punë, punonjësit e tyre t'i mbrojnë punonjësit e tyre, të kërkojnë rritje pagash për ta. Dhe ne jemi të hapur për këtë punë, bile unë nuk e fsheh këtë punë që çdo përgjegjës sektori apo drejtor. Një ditë të vijë të ballafaqojë me ju dhe me mua bashkë. Pagat e tyre do të kërkojnë rritje pake për punën që ndoshta është e papaguar apo nuk veten nivelet e tyre. Dhe unë po hyj në në pjesën tuaj, po bëhem pjesë me ju për të parë të mundshëm që të themi po, ky që punon pa ndërprerje, nuk e ka ta marrë unë në telefon që të vijë të shikojë. U çua kanali apo u bllokua qyteti, apo u bllokua rruga, apo e gjej atje me çizme para meje. Ky është për t'u vlerësuar. Po kur unë shkoj para tij në një bllokim që kam, atëherë kjo lë vend për t'u rishikuar dhe për t'i bërtitur situatës. Kështu që jemi në një prizëm, jemi në një linjë për këtë pjesë, bashkërisht të gjithë. Edhe unë jam dakord edhe me vërejtjet që bën veçanërisht grupi i opozitës. Mazhoranca çik më në kuptimin më të mirë të fjalës e duket në një farë mënyre që rëndon pjesën e ekzekutivit, rëndon punën e bashkisë, por ne duhet të jemi objektivë në këtë pjesë. Njerëzit, njerëzit, ne na shikojnë çdo ditë. Dhe njerëzit kërkojnë sa më shumë punë efektive nga të gjithë, nga muaji i parë e deri tek sanitarja, pa e ofenduar për pozicionin që ka për atë punë që bën. Që shkolla të jetë e ngrohur, shkolla të jetë e pastër, jo vetëm brenda mureve të shkollës, por edhe në territor. Dhe njeriu patjetër të kërkojë pagesë dinjitoze për punën që vetë u zgjata shumë, se e kam ngërç me veten time këtë punë, jo me ju. Ë kemi bërë një njësim afërsisht të pozicioneve të përgjegjësave të drejtorëve deri diku, por nuk mund ta quaj njësoj një drejtor që merret me prokurimet publike, me një drejtor që merret kujt unë meq, që mos zë emra për peshën që ka, për përgjegjësinë që ka, për çdo gjë që ndodh apo dhe një drejtor financë. Po i njësuam kështu me një të rend lapsit, mua më duket jo normale. Që ne duhet t'i përafrojmë dhe t'i ngarkojmë punë, që edhe ata të jenë efektiv. Kjo po jam shumë dakord, dhe ai edhe le të jetë kjo një apel për të gjithë. Që thonë kryetar, unë kam patur këtë rezultat deri dje, e kam arritur këtë punë dhe kërkoj edhe të jetë objekt, të jetë i bindur që do të shikohet me efektivitet nga ne dhe besoj këshilli do ta, do ta marrë në konsideratë. Ke bërë disa rregullime. Mund të ketë ndonjë gjë, se nuk do të thotë që çdo gjë që them unë bëj unë është absolute dhe mund të mos ketë disnivele të cilat kërkojnë rregullim. E kemi diskutuar me komisionin e financës dje dhe i kam thënë që jemi duke pritur një fond nga akti normativ i fundit i qeverisë. I cili tashmë është miratuar në një vlerë dhjetë shtatëqind e pesë milionë lekë, i cili ul pak investimet, detyrimet e investimeve në proces. Dhe i gjithë ky fond do të kalojë për një rritje pagash të punonjësve të

administratës, që nuk u është rritur paga. Nuk ia kemi prezantuar me pesë mijë lekë në muaj. Te i cili ka një efekt rreth nëntë milionë të reja për gjithë vitin buxhetor, i cili vjen si propozim sot, edhe pas diskutimeve që kemi bërë me komisionin e financës në mbledhjen e djeshme. Në lidhje me administratorët, është e vërtetë, pagat e tyre nuk janë në nivelin e duhur, por, unë do desha që edhe administratorët të jenë të punojnë sa gjysma e kryetarit të bashkisë. Të bëhem modest me veten time një herë të them që punoj dhe asnjëri s'ma mohon që unë punoj orar pa orar. Cili është efektiviteti im? Nuk e di, por administratori nuk është të rrijë në zyrë. Administratori duhet të jetë kudo ku ka një problem territori i tij. Në qoftë se ka një kanal të bllokuar diku dhe Astriti si Drejtuesi i bordit nuk e ka bërë, se ka rritur, se ka kapur, se e kanë zënë fermerët për të vaditur dhe ajo shkakton një përmbytje. Administratori duhet ta ketë kapur vetë apo me punonjësit e tij, vetë apo me sektorët përkatës, administratori duhet të jetë çdo ditë në territor pranë familjeve, pranë çative, të cilat mund të kenë nevojë për t'u riparuar, dhe nuk e dimë kush duhet të bërë e para, kush duhet të bërë e dyta. Ku ka një llambë të djegur, unë duhet të merrem. Tani llambë nuk ndërrohet derisa të ndërhyj unë që të ndërrohet llamba. Kështu s'duhet të funksionoj më, jo. Ne kemi llamba në magazinë, kemi ndriçues në magazinë, kemi kabllë në magazinë, kemi çdo gjë në magazinë, kemi mungesa në magazinë, patjetër. Por çdo gjë që ka magazina duhet të dalë në terren. Dhe që kjo dalë në terren, administratori duhet të jetë zëri është kryetari i bashkisë për atë njësi. Megjithatë, pavarësisht kësaj, do ju propozoja të që administratorëve të kenë një shtesë pagë me dhjetë mijë lekë nga paga e vitit të kaluar. Në lidhje me propozimin apo atë që thoshin që bujqësia duhet të jetë drejtori, kini shumë të drejtë, po shikohet nga ana jonë, megjithëse dua t'ju them që kemi mungesë të mirëfilltë të specialistëve të mirëfilltë të bujqësisë në territor. Nuk kemi aq shumë specialistë, edhe pse dalin çdo ditë. Kanë ndryshuar edhe këto nocione tani, inxhinier agronomik, etjera, etjera. Pa hyrë fare në këtë pjesën e fillimit të inxhinierëve, ne na duhen specialistë të mirëfilltë bujqësie, po them të rangut të Lulit. edhe të Selos.Dakord, meqë e kam përballë këtu, po dhe të selos, po të gjithëve specialistët, dhe unë jam, kam qenë transparent në këtë pjesë që na duhet. Specialistë të mirëfilltë që t'i shërbejnë fermerëve, jo të rritim numrin në mënyrë fiktive, edhe pastaj nuk i ndihmojnë, as për sëmundjet që ndodhin në territor, as për farën e mistrit, sa ditore duhet ta mbjellë, që mos ia zërë as bryma. As përmbytja, larg qoftë, e tjera, e tjera. Dhe në këtë prizëm, unë mendoj, jam i hapur. Jemi duke e menduar këtë për ta kthyer një gjë të tillë, por duhet bërë në rangun e. njësimit të disa strukturave, edhe pse ne jemi një çik specifik për peshën që ka bujqësia në territorin tonë. Por atë çfarë ndodh, kini shumë të drejtë që derisa ne quajmë drejtori, kujton shërbimin social apo kulturën. Bujqësia patjetër duhet të ishte e para para këtyre. Dhe është duke u parë nga ana jonë, edhe pse në një vit më parë ne bëmë disa ndryshime të agjesisë, edhe doktori tha pse nuk se e ngritëm me të madhe me të tjera. Unë nuk e kam për ta deklarojnë në kuptimin që nuk ma dha atë që unë prisja. Se ndarja u bë që paralelisht të punoheshin dy drejtime, në mos punonte vetëm një zyrë shërbimesh, një zyrë prokurimesh, po të punonin disa. Dhe në një moment, kur një punë katër veta bënin një punë, një shërbim, një prokurim të punojë tetë veta njëherësh. Nuk na i dha atë rezultat që duheshe. Po kjo po të marrim në konsideratë edhe një propozim që na ka ardhur për ndryshimin për njësimin e strukturave në nivel kombëtar për pushtetin lokal. Pamë të arsyeshme, kjo propozonim. Dhe kemi bërë ndryshime, ajo gjithmonë kërkon ndryshime, kërkon reflektim, kërkon. Unë i qëndroj përsëri asaj fjalie që njeriun që është punëtor, mere dhe vë edhe në një strukturë që s'ka të bëjë

me atë strukturë, ai do ta nxjerrë veten e tij për efekt të performancës dhe të asaj që ka mundësi që mund të bëjë. Njeriu duhet të hapë punë e para. Nuk është gjithmonë që duhet t'i kërkosh punë, jo. Duhet të hap punë, të kërkoj mbështetje, edhe të gjej edhe rrugë të pashkelura, të cilat nuk mund t'i sjell unë. Katërqind punonjësve, pesëqind punonjësve t'i çpoj çdo ditë e t'u kërkoj çdo ditë. Jo, prandaj dhe ka struktura. Ndaj dhe ka struktura dhe po të shikoni në këtë në këtë buxhet, i kemi dhënë peshën. Të kemi dhënë peshë edhe dy nënkryetarëve të bashkisë. Njëri nga nënkryetarët do jetë edhe person autorizues për mbështetjen time, që mos jem unë në momentin që unë nuk ndodhem këtu. Nuk bëhet asnjë firmosje, sepse s'ka kush të firmosi një nga nënkryetarët që unë do ta delegoj firmën për shërbime të ndryshme në bazë të ligjit. Dhe për të bërë të mundur që çdo gjë të eci, të punohet çdo ditë, dhe unë të kem edhe angazhime të tjera në konferencë, në një e tjera e tjera, të mos hyjmë. Në këtë prizmën e të dy, kurse pjesa tjetër do të jetë në varësitë e tjera të sektoriale për të parë çdo gjë që ndodh në territor. Por unë i qëndroj asaj, duhet një mëndësi tjetër nga të gjithë. Ndoshta dhe nga mua nuk e dija, u përgjigja të gjithëve se më mori. Më mori vorbulla, ja sa ti dal gjer në fund, se mund të kem harruar ndonjëherë.

Yllson Ibrhhimllari:Për të ta rishjellë në vëmendje, po.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kush prodhon më shumë, do të marrë më shumë. Kjo është e vërtetë. Jo, nuk është vetëm problemi.

Yllson Ibrhhimllari E lamë atë, e morëm vesh që të dy e kuptuam. T'i themi më pjesë kësaj, ku na vret këpuca. I themi ne këtej nga anët tona.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për Sekretarin e Këshillit?

Yllson Ibrhhimllari: Atë e zgjidh kryetari, e zgjidh veten. Mos u shqetëso ti, aq më shumë që kemi arritur këtë ditë që të kemi demokratizuar në lënien e përgjegjësive në vendimarrje. Ia arritëm më në fund kësaj, meriton një bravo të madhe. Të rrimë këtu ku jemi te plaga jonë. Jemi qytet që kemi universitet bujqësor shumë afër. Unë besoj që ajo drejtoria duhet të funksionojë si e tillë dhe ndoshta me honorare, me partajm, me një bord tjetër specialist të tillë të ketë. Është një projekt i Zotit Damo që unë nuk e njoh personalisht, për ruajtjen e farave në zhdukje në territorin e Bashkisë së Korçës, bankot e farave quhen ju që keni mbaruar agronomi. Besoj që njerëz të tillë gjenden akoma në këtë hapësirë, që mund të jenë edhe të pensionuar, por mund t'i vijnë si konsulentë. Kam parasysh atë komisionin që funksionon shumë mirë, atë që keni ngritur ju për titujt, që funksionon shumë mire, jep përshtypje të vazhdueshme mund t'i merrni të honorizuar me honorare. Këshilli mund të marrë vendime të tilla që pesë akademikë agranomë. Të vijnë tek bordi, tek kjo drejtoria e bujqësisë, e mos flas si doktori për bujqësinë, se e ka zënë të keqe. Se na s'mur edhe kryetarja një ditë përpara mbledhjes, si t'ia bëj? Do ta marrim ne përsipër rolin e opozitës këtë. Faleminderit.

Almir Elezi: Kryetar, unë desha të të thosha këtë, meqënëse ti the që punëtorët nuk ma bëjnë punën siç duhet, si ai rasti që përmendej në përmbytje. A ke marrë ndonjë masë ti, ti shkarkosh këta persona që nuk ta bëjnë punën tamam si duhet?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, shiko, mirë është të mos luajmë me fjalën e njëri-tjetrit. Nuk ta thashë këtë unë. Pasi kjo ç'ndodh, u kam çuar sot një material për përmbytjet goxha të gjerë dhe u kam shpjeguar çdo gjë që ndodh. Çdo gjë që ka ndodhur, çdo gjë ju kam shpjeguar që bashkia është administratore vetëm e kanaleve të dyta takulluese. Me ligj edhe e tridhjetë e një, mos gaboj, ujëmbledhësash në territor të cilët menaxhohen nga ne njëzet e katër orë në njëzet e katër. Gjithë pjesa tjetër, lumenjtë, kanalet e para, kolektorët, siç i thonë. Edhe brazat kulluese apo kanalet e tretë menaxhohen nga struktura të tjera dhe nga fermerët. Bile, jemi në në tetativ me shoqatën kombëtare të bashkive. për të bërë të mundur që bashkitë të marrin në pronësi dhe kanalet e treta, se askush, tani duhet ta pranojmë, nuk merr një lopatë e të hapë një brazë kulluese në tokë e tija, e cila mund të mbytë. Njëzetë dy nyjë vetëm se duhet hapur gryka e brazdës, apo brazdat i kanë mbyllur fare për të fituar tokë bujqësore. Mos të themi pastaj ovratet e tjera, tjera do të thuash ti, po kush e ka përgjegjësinë? Nuk është në pronë të bashkisë, është midis fermerëve. Duhet të vijnë ne kur na vijnë, bile kur na kërkojnë t'ia pastrojmë, vemi ia pastrojmë, edhe pse nuk i menaxhojmë ne jemi në territor dhe po të shikosh me atë informacion që u kam dhënë, largimi i ujërave nga fusha. Për fushën normale ku ne kemi pastruar kanale kullusë e vadis, është kthyer në një kohë normale qind për qind, duke u larguar ujit nga kanalet e pastruar. Se në qoftë se kanali s'do ishte i pastruar, do mbetë që uji atje do qëndronte. Kanale dhe dhe vajtën në rrjedhë normale hyn lumë, përjashtuar pjesa e djegur që është e vështirë derisa të bjerë niveli i kolektorëve pasi, hyn në punë edhe infiltrimi, etjera, etjera, dhe që të vete tek pyetja juaj, nuk thashë që nuk ma bëjnë, nuk e bëjnë punën mirë. Ka vend për rishikim kudo, nga muaji i parit thashë, nga muaji që mbahem sikur punojnë qind më shumë se të tjerët, se e kam përgjegjësinë më të madhe. Por nga mua mora indicien nga doktori, kur më tha për administratorët që thashë, po duhet të rrinë shumë në zyrë. Do të thuash, ja u ke thënë, po po ja u kam thënë, patjetër që ja u kam thënë, ju kam thënë, ju kam vendosur një orar pune, tetë me dhjetë rrjetë në zyrë, priten njerëzit e tjerë dhe pastaj dhjetë me të paktën katërmbëdhjetë duhet të jenë në territor për të parë sipas një programi të caktuar çdo fshat, çdo shkollë, çdo vorrezë, çdo kanal, çdo rrugë etjera etjera dhe për të marrë masa vetë. Në qoftë se vetë nuk i zgjidhin dot, atëherë vijnë tek mua dhe kërkojnë mbështetje. Kaq e thjeshtë është.

Almir Elezi: Jo, unë e kisha në rastin konkret të mbylljes së asaj digës që shkaktoi përmbytje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kush digë?

Almir Elezi: Po që shkaktoi përmbytje kjo e Dunavecit. Por që ishte e mbyllur,

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: nuk ka patur, por të mbyllur.

Almir Elezi: Ka patur edhe ka shkaktuar përmbytje, edhe tashi ky që ishte përgjegjës i kësaj hapjes së digës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj që këtë pikë të hyjmë në zonë në pika e të përmbyturve ta marrë me radhë, se sa të mos dalim nga pika kryesore. Do isha që ta ndaj këtë pjesë. Do ju propozoj që të gjithë punonjësit e administratës së bashkisë, për të cilën nuk është reflektuar rritje pagë. Tek projekti që kemi sjellë, të bëhet një rritje pesë mijë lekë në muaj administratorëve të në bazë të popullsisë. Të kenë një dhjetë mijë lekëshe në muaj dhe pjesa e Gorës dhe e Moglicës me pesë mijë lekë në muaj.

Yllson Ibrhhimllari: Sipas kategorizimit, siç e kanë, është një milion e katërqind e pesëdhjetë mijë lekë paga e administratores së Libonikut. Sipas kriterit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo patjetër, në qoftë se doktor ke ardhur të na bëhesh oponent për brenda vetes.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, më vjen keq, po pse? Jo, jo, kam dëgjuar shpesh që jemi mazhorancë, jemi kështu. Këtu kemi secili një opsion për të përmirësuar gjërat.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të gjitha pagat. Të gjitha pagat, jo vetëm e administratorit, jo vetëm administratorëve të këtyre që folit ju, por të gjithë punonjësit e administratës. Kanë një nivel të rritjes së nivelit të pagave në masën shtatëdhjetë për qind. Edhe specialistët që ke këtu, edhe drejtorët nuk i kanë pagat, i kanë nivele shtatëdhjetë tetëdhjetë për qind. Se kaq është mundësia jonë paguese, se duam të bëjmë investime dhe shërbime në komunitet.

Yllson Ibrhhimllari: Po ju lutem, se e morët kshu si personale. Duam neve, do japim pesëdhjetë. Do t'ju japim pesëdhjetë, do t'ju japim njëqind. Atëherësh, neve ju japim. Sa mundemi dhe ju kini ato kritere tuaja të llogaritjes, por të jemi sikur kjo nuk vjen nga iniciativa jonë, kjo vjen nga puna jonë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po për këtë po them edhe unë, atëherë po ju, po ju,

Yllson Ibrhhimllari: Kush se bën punën të iki?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po ju citoj diçka. Administratorët të ndryshojnë performancën gjer në qeshor, t'ia çojnë maksimalen. T'arrijnë, t'arrijnë këtë që unë po them, mos kem ankesa për llamba të djegura, për kanale të bllokuara, për plehra vend e pa vend, e tjera, e tjera, që të ndjekin çdo ditë punën në territor. Kjo ishte ajo që ngre unë, dhe kjo është puna ime për t'i kërkuar atyre, dhe nuk është vetëm për administratorët. Është po ajo për çdo drejtues të një sektori, të një njësie, të një drejtorie brenda bashkisë apo jashtë bashkisë.

Ornildi Demollari: Iidlir, ke fjalën.

Idlir Limllari:Përshëndetje, kryetar në lidhje me këtë të bujqësisë, edhe për mungesën e personelit. Mendoj që inteligjenca artificiale në një farë mënyre mund të na ndihmojë në këtë fushë, por bujqësia faktikisht ka nevojë për vaditje dhe fusha e Maliqit nuk ka më sç kishte mbarë dhënë vendtroku, nuk punon. Mendoj që duhet një elektrifikim i fushës që Fermerët me puse të vogla mund të vënë një pompë me korent. Ajo do u ulë koston dhe do rritë prodhimin. Gjithashtu. Gjithashtu, mund të në këta punonjësit e bashkisë që ke, mund të vendosen dy-tre veta në një fidanishte dhe ajo do ndihmojë shumë me fidana.Qoftë edhe për të fillëzuar. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj, kryetar, unë mendoj të kalojmë strukturën. bashkë me disa propozime që unë bëra në këtë moment. Edhe pastaj, kur të shikojmë edhe buxhetin në total, edhe investimet në nivel programi, edhe investimet prioritare, do t'ju jap disa sqarime. Si e ke menduar ne? Edhe propozimi që bënit për të cilën ne po mendojmë, nuk është kaq e thjeshtë të elektrifikosh një fushë kaq të madhe, por ne kemi menduar që mund ta bëjmë me zona pilot, të cilët shikojmë cili do jetë efektiviteti i tyre. Të shpresojmë që të jetë sa më parë.

Ornildi Demollari: Kur të shkojmë tek materiali i investimeve, zgjerohemi, se vura re që u zgjeruam tek struktura në këtë, në këtë pjesë. Ju lutem për strukturën, tani e kalojmë në votim?

Yllson Ibrhhimllari:E fundit, do shtojmë drejtorinë apo jo?Se jemi dakord.

Lulëzim Hoxhaj: Se u bë propozim edhe nga Kupja.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ja një moment. Tani, propozimi që bëri Petriti ishte, nuk ishte thjesht një drejtori, vetëm bujqësia. Propozimi ishte për bordin e kullimit.

Lulëzim Hoxhaj: Jo, jo, një drejtori, dhe brenda kësaj drejtorie është bordin e kullimit. Po, pra, dakord, dakord. Ajo i përmbledh të gjitha.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Prandaj, prandaj, ma lini ta shikoj. Pagat janë aty në një moment, mund të lëvizë vetëm paga e një drejtuesi që mund të jetë kjo strukturë, por gjithë pagat do të jenë aty. Ta shikojmë dhe t'u sjellim një propozim konkret, mos e bëjmë të nxituar sot. Ta mendojmë, jam shumë dakord, jam shumë dakord.

Lulëzim Hoxhaj: Ideja është kjo në rast se bujqësia shndërrohet në drejtori, brenda kësaj drejtrie janë bujqësia që është sot si sektor, bordi i kullimit, ujitja.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Të kuptova, të kuptova, ideja është, ideja është, na lini ta mendojmë që t'ia sjellim si propozim, si projektvendim. Se nuk mund ta bëjmë këtë nxituar sot, se duhet edhe kur bëhet një strukturë, fillohet me njerëzit. Se unë dua ta mendoj ore mirë, ja e

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

bëmë, kush do jetë? Po das se s'paskemi drejtor, duhet ta shikojmë kush do ta marrë përsipër këtë pikë. Për efekt të shkollës, për efekt të gradës, për efekt të kësaj, për efekt të kësaj që t'i japim një impunto, mos ia futim kot. Pa lini në një periudhë shumë të shpejtë, unë të sjell propozimin konkret. , po ta mendoj, mos e bëj të nxituar.

Ornildi Demollari: Faleminderit, atëherë e kalojmë në votim strukturën me ato ndryshimet që përmëndi kryetari. Në shtesat që prezantoi,
Kush është dakord? 29 vota pro.
Kundër nuk ka,
Abstenim nuk ka, me njëzet e tetë vota pro miratohet. Faleminderit. Tani të kalojmë tek pika gjashtë e rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e buxhetit. Të bashkisë për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, lutem, komisioni i financës na bëj një.

Petrit Kupe: Ne në komision do përmendim ndryshimet që ka ky mulçi në krahasim me vitin dy mijë e njëzet e pesë, si mbas pasqyrave të bashkëngjitura. Transferta e pakushtëzuar rritet. Nga katërqind e njëzet e tetë milionë lekë të mbllakosura në katërqind e dyzet e shtatë milionë lekë, poster greth nëntëmbëdhjetë milionë lekë të reja. Buxheti i pavarur ose të ardhura nga taksat nga treqind në treqind e njëzet milionë lekë, ndërsa transfertat historiale nga dyqind e njëzet e tre milionë lekë në dyqind e pesëdhjetë e dy milionë lekë. Pra, kemi një rritje të konsiderueshme të gjithë totalit të buxhetit në masën tetë për qind. Është një nga buxhetet më të mëdha. të realizuar në Bashkinë e Madhe që nga viti dy mijë e pesëmbëdhjetë. Po, kjo është pa bërë këtë shtet të sotme dhe kjo e rrit akoma më tepër rreth dhjetë deri tetë deri dy për qind transferta për përballimin e fondeve të prapambetura dhe për rritjen e pagave. Pra, është një buxhet i konsiderueshëm në këtë strukturë të buxhetit. Fondi i pagave zë pesëdhjetë e tetë për qind shpenzimet operative , zenë trembëdhjetë pikë gjashtë për qind dhe fronti për investime njëzet e tre për qind ose dyqind e gjashtëdhjetë e një milionë lekë investime që janë në proces, ose investime që do të kryejnë gjatë vitit dy mijë e njëzet e gjashtë. Buxheti i madh do të thotë punë më të mëdha, punë më të mira, për komunitetin dhe jemi dakord ta miratojmë atë merak që kemi patur gjithmonë. Kemi realizime të ardhura, mbasi fund. Buxheti është i planifikuar treqind e ca njëzetë milionë lekë, por jemi të koshientë që kjo shifër nuk arrihet. Po shërben si mjet për të përdorur për investime në proces. Kjo është një nga pikat që kërkon punë konsiderueshme, mbasi edhe punonjësit që përfshihen në drejtorinë e tarave, është një numër i konsiderueshëm rreth 40 punonjës që synojnë të realizojnë këtë buxhet që parashikon bashkia. Ndryshime të tjera në buxhet kanë disa ndryshime në krahasim, siç thamë në fillim në dy mijë e njëzet e pesën, disa nivele. Është paga e shpërblimit të këshilltarëve. Kryetari ka menduar të bëjë një diferencim sipas numrit të popullsisë së fshatrave, me gjashtë për qind, tetë për qind e tjera. Nga cila i vjen në kushte të barabarta fshatrat në një mijë banorë, një mijë deri në tre mijë dhe mbi tre mijë banorë? Këto kishin ndryshime për buxhetin. Faleminderit.

Ornildi Demollari:A ka ndonjë pyetje të? Përpara se t'i japim fjalën kryetarit ose ndonjë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të them unë diçka dhe pastaj se ndoshta po i ngacmoj ose u kthej në një përgjigje unë nga ajo që po urdhëron.Tani, buxheti në total ka një vlerë një miliardë zero nëntëdhjetë e tre milionë njëqind e tridhjetë e pesë mijë lekë. Me një rritje rreth tetëdhjetë e tetë katërqind e gjashtëdhjetë e tre mijë lekë, apo me një shtesë tetë për qind nga viti i mëparshëm, transferta e pakryshëzuar rritet me tetë pikë dy për qind. Apo me tridhjetë e nëntë milionë lekë, po i rrumbullakos për efekt kuptimi. Kemi një fond të dedikuar për rritjen e pagave në një vlerë shtatëdhjetë e dy treqind e tridhjetë e një mijë lekë. Dhe një fond për menaxhimin e mbetjeve shtatë gjashtëqind mijë lekë. Transferta e pakushtëzuar sektoriale ka një shtesë, njëzet e nëntë mijë lekë në mijëra lekë, e cila vjen për efekt të rritjes së pagës minimale për punonjësit mbështetës apo për pagat e personelit arsimor, siç janë edukatorët e kopshtit. Transferta e përgjithshme në buxhetin e vitit dy mijë e njëzet e pesë kap një vlerë shtatëqind e shtatëdhjetë e tre njëqind e tetë mijë lekë, apo me një rritje nëntë pikë shtatë për qind nga një vit më parë. Po të shikojmë ndarjen dhe po të bëjmë detajimin e pagave dhe sigurimeve shoqërore për buxhetin e bashkisë dhe për atë që është transfertë sektoriale. Pagat kapin një vlerë pesëdhjetë deri në pesëdhjetë e dy për qind, investimet njëzet e tetë deri në tridhjetë për qind. Shpenzimet operative apo dhe të tjera, siç janë gjashtëqind e gjashtë të tjera ndaj të tretëve, kapin një vlerë njëzet e njëzet e dy për qind. Ne kemi një tabelë të bashkëngjitur që ia japim, që në një farë mënyre quajmë regjistri i parashikimeve të prokurive publike për vitin buxhetor. Po të shikosh aty, nuk ka shpenzime ekstra në kuptimin, për të parë që shpenzime vend e pa vend, kjo pastaj krijon një nonsens midis lekëve që grumbullohen, lekëve të buxhetit të shtetit që fonde të cilat ndonjëherë nuk shkojnë për shërbime ndaj komunitetit, por për shërbime luksit, themi nuk ka të tilla. Përjashtuar dyzet e njëzet që kemi futur, po ta shikoni pjesën e investimeve në nivel programi. Megjithëse do ta shikoja në këtë linjë për ta bërë të mundur që edhe ajo është pjesë e buxhetit. Kemi parashikuar një fond rreth një milion lekë për hartim projektesh, që ndoshta edhe më shumë duhet. Kemi një fond për ndërtime konstruksione. Mendojmë, janë shtuar kërkesat edhe të komuniteteve edhe të banorëve për efekt të rikonstruksioneve të ndryshme. Të banesave kolektive, për të cilat unë mendoj që duhet mbështetje dhe edhe suport nga të gjithë. Ato janë banesa private, të themi, pavarësisht se janë në bashkëpronësi. Edhe kontributi duhet të jetë i tyre, i parëve, dhe ne duhet të jemi mbështetës. Kemi vlera pesëmbëdhjetë milionë lekë. Kemi futur një fond bashkëfinancim projektesh rreth dy milionë lekë, që mendojmë që mund të kemi një bashkëfinancim jo vetëm për çatitë e familjeve, të komunitetet nevojë, po jemi duke menduar të kemi një bashkëfinancim edhe për vazhdimin e rrugës së Kolanecit. Me këshillën e qarkut Korçë, i cili do të mendojmë që do të realizojë edhe aty një fazë të avancimit të rrugës së Kolanëcit, të shpresojmë që të njëjtën do të ndjek edhe rruga e Strelcës, e cila janë dy rrugët që ne po mendojmë për t'i përfshirë në dy zonat turistike malore të bashkisë sonë kemi parashikuar një fond pesë milionë lekë për rehabilitimin e objekteve sportive. Kemi menduar. Është një objekt në fshatin Vloçisht, ish-kinemaja, që duam ta trajtojmë për ta kthyer në një palestër, mini palestër të themi, për shkollën e këtij fshati dhe fëmijët e asaj zone. Është një qëndër tjetër në Vreshtas dhe cilën duam ta trajtojmë, apo dhe rrethimet e terrenit sportive të fushave sportive, të cilat kërkojnë ndonjëherë mbështetjen tonë. Por kjo vlerë mendojmë që do të ketë një rishikim në buxhetin shtesë të bashkisë, ku ngelen fonde që edhe nga arsimi në mënyrë të konsiderueshme, ku mendojmë që shkolla e Sovjanit do të ketë një peshë të konsiderueshme në rehabilitim të

territorit të jashtëm, por dhe brenda saj. Por në varësi të saj, do të flasim në momentin që do të miratohet edhe buxheti apo do t'i sjellim propozimet për buxhetin shtesë. Kemi parashikuar rreth pesëdhjetë e një milionë lekë për rehabilitim rrugësh në territor, nga të cilat gjashtë milionë lekë për betonim kthesash pjesë malore në Gorë dhe në Moglicë. Një fond pesë milionë lekë për kanalizimet e ujërave të zeza. Kemi disa problematika të vogla, të cilat nuk i kemi mbyllur në Bregas, në Burimas, në Vloçisht, në Libonikë kemi një kolektor kryesor në pjesën fundore. Kemi një fond tre zero pesëdhjetë e katër milionë lekë për rikonstruksion veprash ujore, për të cilat drejtoria e ujit të kullimit po mendon mund të jetë edhe ndonjë nga ushqysët e rezervuarve të cilët. Janë kërkuar nga banorët apo kanale betoni, të cilat ndonjëherë shërbejnë për përmirësimin e ujitjes në fushë. Pajisje dhe instalime teknike kemi parashikuar prapë katër milionë lekë për ndriçues rrugor. Kemi parashikuar një fond rreth 2.2 milionë lekë për pajisje për shërbimin zjarrfikës. Jemi të hapur ndaj atyre, mos iu mungojë asnjë pajisje apo orendi që u shërben. Një nga strukturat tona më efektive dhe që nuk kemi kursyer asnjëherë që ata të jenë të mbrojtur nga zjarri. Në mjetet e transportit kemi parashikuar. Duam të blejmë dy makina elektrike për të bërë të mundur uljen e shpenzimeve të karburantit. Pasi me financimin që Fondi Shqiptar i Zhvillimit na realizoi, kemi instaluar edhe një pajisje për karikimin e makinave dhe mund të jetën dy makina që do i shërbejnë gjithë administratës së bashkisë, duke futur dy makina të tilla edhe duke nxjerrë disa makina që kanë më shumë kosto se sa fitim në këtë pjesë. Po të marrim koston e riparimit dhe koston e karburantit. I bie që duhet të blinin tre katër, po po blejmë dy si moment të parë për të parë rezultatet. Kemi menduar të blejmë një makinë grirëse mbetjesh të gjelbra në territor. Është për herë të parë që e bëjmë. Duam që të kemi një makinë me rimorkim që ta çojmë vend e pa vend, ku na hedhin mbetje të kopshteve të parcelave t'i grimë, duke i kthyer në sillash. Dhe duke krijuar një linjë të përpunimit të tyre dhe të kompostimit, mendojmë ta kthejmë, ta realizojmë në fshatin Rrëmbec. Me një sektor të vogël, i cili do t'i çojë dhe do t'i krijojë ndoshta edhe të ardhura për prodhimin e plehut, jo vetëm për nevojat e bashkisë, por edhe për të shitur. Në inventarin ekonomik kemi futur një fond dy milionë lekë blerje kompjuterë printash dhe një mobilim apo pajisje për shërbimin zjarrfikës. Janë fondet e tyre. Dhe ne i kemi kanalizuar sipas kërkesave që ka bërë kjo strukturë. Kjo ishte për pjesën e investimeve. Shpenzimet operative në një farë mënyre kanë ruajtur të njëjtat nivele. Jemi munduar të hedhim në strukturat tona zërat më të mëdha, kapin materialet elektrike, materialet hidraulike. Çakëll për fushë për riparimin e rrugëve të parcelave, çakëll për riparimin e rrugëve në zona të caktuara, të cilat kanë nevojë. Asfaltim të zonave të dëmtuara, gropave e prerjeve të tjera, është një pasqyrë të themi e konkluduar mirë, ndoshta kërkesat ndonjëherë janë më të mëdha, por ne i shikojmë zë për zë derisa vemi në një definicion përfundimtar për t'ia prezantuar, por në qoftë se ka pyetje konkrete, unë jam i hapur t'ju kthej përgjigje, pasi normalisht besoj se e njoh mirë çdo zë dhe çdo pjesë të buxhetit, që nga një rubinet çezme deri tek një rrugë, shumë faleminderit.

Faslli Zholi:Përsa i përket buxhetit të vitit 2026, edhe unë në emër të opozitës do të shpalos nja dy vendime dhe ide dhe këndvështrimin të cilët neve kemi. Të nderuar kolegë këshilltarë, i nderuar kryetari i këshillit, i nderuar kryetari i bashkisë, të nderuar pjesëmarrës. Sot, kjo mbledhje, si gjithmonë, ne i kemi zhvilluar dhe sot kjo ka një rëndësi të veçantë për mua dhe për të gjithë secilin nga ne. Sepse miratojnë paketën fiskale, buxhetin e vitit dhe administratën e

bashkisë Maliq. Por sot, mbledhja e fundit të vitit merr një rëndësi të veçantë për ne si këshilltarë dhe për të gjithë ata që na dëgjojnë. Për të mbërritur në këtë pikë, ne të gjithë jemi koshientë, të gjithë përkushtimin dhe planit dhe detyrat sipas fondeve dhe nevojave të qeverisë lokale në nivel ish-njësi vendore dhe deri tek bashkia e Maliqit. Për të sjellë unë personalisht si anëtar i këshillit, kam marrë pjesë. Në dëgjuesat publike, të cilat janë zhvilluar në fshatra edhe në njësi vendore, ku jasnë shpalosur idetë, kemi dëgjuar edhe qytetarët. Kemi dëgjuar edhe një plan nga kryetari i bashkisë të detajuar për këtë qëllim që ne mbërrijmë në këtë pikë. Po me shumë vëmendje duhet të marrin shqetësimet, propozimet dhe mendimet e ndryshme të cilat qytetarët kanë shfaqur gjatë këtyre dëgjesave. Të cilat ata kërkojnë më shumë, kuptohet, sesa neve u japim. Kjo ka bërë që në tërësi kontaktet me qytetarët për hallat dhe problemet e tyre, ne i kemi njohur edhe si këshilltarë të zgjedhur po nga këta qytetarë. Për të gjitha këto, kërkohet një shpërndarje e plotë dhe efikase në këtë buxhet, me zëra të cilat neve kemi disa mendime. Që të flasësh për buxhetin do të thotë të kesh lekë. Dhe që të kesh lekë, duhet të thamë edhe atë që duhet të kemi të ardhura. Që të kesh të ardhur, duhet të kemi projekte për të thithur këto të ardhura, të cilat secili i di, por neve po i citojmë. Bashkia e Maliqit është një bashki me drejtim bujqësor, për të cilën edhe e diskutuam. Dhe këtu mendojmë neve, edhe si opozitë, edhe si këshilltarë. Që duhet të jetë investimi më i madh tek bujqësia, përse është bërë një punë edhe me kanalet, pa u futur tek përmbytjet e tjera, të cilat ishin edhe fatkeqësi natyrore. Ka dhe të tjera gjëra të cilat nuk kanë shkuar mirë, sepse neve këtu jemi një bashki me drejtim bujqësor dhe mirë u kërkua dhe mendimi që edhe drejtoria të shikohet. Kjo pra është një anë e medaljes. Buxheti i vitit dy mijë e njëzet e gjashtë, si dhe prioriteti i bashkisë Maliqt, janë teza politike kryesore që sot ne e mbështesim në të. Deklaratat dhe që kemi materialet përpara këtu. Ky buxhet i dy mijë e njëzet e gjashtë nuk është një buxhet për neve si opozitë proletar. Por duhet të të parë si një buxhet shpërndarjesh të parave, sepse zyrtare kur totali i fondeve për investimet për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë. Është në vlerën dyqind e gjashtëdhjetë e një pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë lekë. Projvendimi i buxhetit për vitin dy mijë e njëzetë e gjashtë, ndërkohë që ka bashkia ekzekutive, i ka paraqitur sot këshilltarëve në këtë seancë tre të dy projekte. Prinoritetet ku për të cilat objekte objektivisht nuk mund që të finalizohen. As pjesërisht në mënyrë reale që na duket neve të bëjmë. Për shembull, në pika numër shtatë e rendit ditës, ku thuhet investimet prioritare, kjo është një kundërshtim me veten, parimin e planifikimit buxhetor, sepse prioritetet do të thotë zgjidhje dhe jo listime. Argumenti tjetër kyç politik e prioritetit të marrë nga analiza e buxhetit është thënë se investimet reale të reja për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë janë njëqind e gjashtë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë lekë. Pjesa tjetër janë projekte të bëra në procesverbal ose të mbetet të. Të mbartura që do të vijnë më pas, projektvendimi numër gjashtë i buxhetit të shtetit të bashkisë me ligj për këtë vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, në këtë nivel fondesh, bashkia në bazë të llogaritetës financimi të thjeshtë ka kapacitete për dy-tre investime, jo tridhjetë e dy, siç na është shkruar në dokument. Është mendimi i opozitës, atëherë kur çdo projekt prioritar në këto kushte s'ka se si të quhet projekte publike. Ky nuk mundet të themi se ka të bëjë me një plan zhvillimi, por ndalet dhe të themi shmangie, pse jo, dhe të përgjegjësive. Për të gjitha këto vërejtje dhe neve në si komision të kemi si opozitë, ishte e rëndësishme të bëjmë publike këto dhe këndvështrimin e opozitës. E ftoj grupin e opozitës që neve këtë buxhet do ta votojmë kundër. Për këto arsye që unë citova më lart, duke i uruar gjithë qytetarët e Maliqtë dhe

familjarët, një vit të mbarë dhe viti dy mijë e njëzet e gjashtë, të jetë i gëzueshëm dhe i lumtë për të gjithë. Faleminderit që më dëgjuat.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kryetar, po shpjegoj edhe diçka. Në lidhje me, do t'i jap një përgjigje ndoshta edhe Faslliut që foli në emër të grupit, unë do ta quaja pozitive në qoftë se ata do të votonin pro, ndonjëherë dyshoje tek vetja ime pse votuan pro, çfarë ka ndodhur, edhe na fusni edhe ne në dilemë, megjithatë. Unë mendoj që ne duhet të jemi objektiv tek ajo çfarë ne duhet të arrijmë, edhe çfarë synojmë. Më erdhi mirë që ishit okej për paketën fiskale, edhe propozime konkrete ishit okej për administratën, që janë pjesë e këtij buxheti. Megjithatë, edhe ju kini një mendim politik dhe s'kam pse ta dyshoj këtë pjesë. Megjithatë, dua të them edhe disa fjalë të cilat janë po pjesë e buxhetit në lidhje me disa shpenzime të tjera që kanë të bëjnë me Emergjencat civile kemi parashikuar një fond rreth katër milionë lekë, një fond për bursat ekselent. Një fond për subvencion qiraje për ata të cilët nuk kanë mundësi të kenë një shtëpi, dhe bashkia do t'ju paguajë qiranë. Jo vetëm me fondet e veta, por dhe me fondet e qeverisë, po kemi parashikuar edhe me fondet tona një pjesë të tillë. Parashikuar një fond për bursat e nxënësve, të cilët kërkesat ishin shumë më të mëdha sesa miratimi që na ka bërë Ministria dhe ne po parashikojmë të paguajmë edhe me të ardhurat tona, që t'i paguajmë qind për qind të gjithë ata që kanë kërkuar të kenë një bursë sipas akteve ligjore në fuqi të paguar. Fond rezervë dhe dy milionë lekë për situata të ndryshme. Ju kemi sjellë një listë të shpenzimeve për karburant për mjetet e bashkisë, duke qenë sa më realiste dhe sa më kërkues ndaj vetes tonë që këto shpenzime të jenë minimale. Kemi sjellë një pasqyrë të pagesës për efekt të anëtarëve të Këshillit të Bashkisë, të kryetarëve të fshatrave, që ka një risi e përmendi pak më pare Komisioni i financës, i cili kemi bërë një rregullim, ka një rritje të shpërblimit të tyre. Ka një efekt rreth dy pikë dy milionë lekë, diferenca nga një vit tek viti tjetër. Ka disa pagesa për shoqatën e bashkive, për Akademinë e Pushtetit Vendor, ku mendojmë që të futim në trajnim të gjithë punonjësit e bashkisë dhe besojmë, dhe kjo është një risi e këtij buxheti. Ka një përllogaritje aty të pjesës së sekretariatit të këshillit dhe përveç pozicionit që ka sekretari i këshillit, kemi futur edhe një punonjës tjetër, i cili do të jetë pjesë në pjesën e bashkisë ta dedikojmë, ta çojmë përsëri aty, ne s'kemi as kundërshtimesh në pozicionin e juristit, i cili do i shërbejë edhe juve për efekt të anës ligjore, anës juridike apo edhe për trajnime të ndryshme. Nuk kemi asnjë problem. Kemi parashikuar një fond për të rinjtë, i cili edhe ky është një pjesë e sektorit të trashëgimisë kulturore të turizmit, e cila në një farë mënyre edhe ajo duhet të marrë peshën e saj, nuk e preka tamam pjesën e drejtorisë që kemi krijuar në kultura, por ajo ka ende nevojë. Ajo godinë që mendojmë që do të jetë shumë shpejt në funksion, prandaj një muaj, një muaj e gjysmë, dy muaj maksimumi. Ne shpresojmë që të që fillimi i pranverës aty të jetë në funksion të plotë, ku ne duam të fillojmë të ngrejmë kurse të çdo lloj që kalamajt, fëmijët, nxënësit të shkojnë aty dhe të gjejnë një mundësi në internet, në mësim në gjuhë, në vegla muzikore do të ketë trajnerë të cilët do t'i paguajmë neve si bashki, që të kemi mundësi që ajo të mos jetë një gjë e fjetur, po të jetë një gjë që të gumëzhi njëzet e katër, njëzet e katër, dhe ajo ndoshta kërkon riformatim herë pas here, që me gjithë atë besim që është bërë, ajo të mos ngelet një gjë e vdekur. Në lidhje me investimet prioritare, se dua ta, nuk janë investimet të cilat ne i futim për t'i realizuar me fondet e bashkisë. Patjetër ka një trend edhe ajo punë, por ne kemi dhënë spjegimet në kolonën përkatëse.

Që nga rrugë të cilat janë rrugë nacionale, duam të realizohet rruga anës liqenit Moglicës. Jemi në tentativa me shtatë kraftin, edhe me Devolli Hydropower dhe me Ministrinë e Infrastrukturës, që në projektin që ata mund të realizojnë projektin e dytë. Nga më të mëdhatë në energjitik në zonën e Gorë-Moglicës, një nga detyrimet të jetë rruga anës liqenit, që do të shpëtonte përfundimisht, në një farë mënyre, në konceptin tim, ajo që është bërë nuk është. Atje ku duhet, rruga tjetër është lidhja e Moglicës me Skraparin dhe Beratin, që është një projekt që e ka bërë Arëshaja dhe në qoftë se do të realizoheshe ky projekt, i cili është njëzet e një pikë shtatë kilometra, që nga Moglica kalon në Zerec edhe del në Del në Tomorr dhe del në Skrapare dhe në Berat, do ishte një nga rrugët më funksionale dhe më zhvillimore të zonës sonë. Por këto nuk mund t'i realizojë bashkia, por ne duhet ta çojmë si prioritet dhe një vendim këshilli, se mora këto dy. Por ka disa nga ato një vendim këshilli, i cili e fut prioritet një rrugë, një investim i të tjera. Është një nga aspektet, një nga pikat që institucionet përkatëse e kërkojnë këtë vendimarrje. E njëjta gjë është për fushën e bujqësisë, për disa projekte që kemi futur aty. Është për rrugë të bardha, për rehabilitim të fasadave të pallateve dhe çative, për të cilat Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Apo drejtoria, ministria e bujqësisë, apo agjensia kombëtare e mbrojtjes civile, kërkojnë një nga elementet. Është edhe ky element, ndaj dhe ajo kemi sjellë. Nuk kemi bërë një listim për të thënë, shiko ç'do bëjmë, por për ka ndodhur që objektet, të cilat ju i keni patur në listat prioritare të një viti më parë, janë finalizuar. Dhe kjo do të thotë që s'kemi pse neve mos mundohemi për ta realizuar. Unë ju falenderoj, megjithatë falenderoj të gjithë këshilltarët për kontributin e majtë e të djathtë, pasi është shumë e rëndësishme, është shumë e rëndësishme. Që të debatojmë dhe t'i çojmë njerëzve edhe mua personalisht vërejtjet e duhura për të rregulluar punën.

Petrit Kupe: Në takimin e djeshëm në lidhje me parashikimin e investimeve, kryetari mori parasysh lënien e një fondi të veçantë. Për një shqetësim aq të rëndësishëm për gjithë komunitetin, për pjesën që, nuk mund të mbulohen me ndërtim të çative ato familje të cilat janë të pa pajisur me dokument. Për këtë, kryetari thirri përgjegjësin e strehimit dhe kërkoi që të krijohen modalitetet, se si do të përgatitet dokumentacioni që edhe kjo pjesë, kjo kategori familjesh e patrajtuar më parë, që janë dhe më të varfra nga ato që kanë përfituar nga ndërtimi i çative. Ndoshta në vitin e ardhshëm të bëhet e mundur të paktën, siç biseduam dhe jam dakord, kryetari. Të paktën me ndërtimin e çative të reja të këtyre familjeve, janë shumë të varfra. Këtë e vlerësoj si një përpjekje tonën dhe një bashkërendim të punës me kryetarin e bashkisë. Desha të thosha për grupin e opozitës derisa ata janë dakord për strukturën për pagat. Apo dhe për buxhetin, nuk do ishte mirë t'ua thonin kundër këtij projektvendimit të prioriteteve. Siç e dha kryetari, prioritetet janë prioritete, nuk janë fonde, nuk janë lekë në buxhetin e bashkisë. Këto janë prioritete të cilat në momentin që bashkia aplikon. Në institucionet nga të cilat çelen fondet, nga fondi shqiptar apo nga fondacionet, duhet një vendim këshilli. Të parën gjë që kërkon institucioni thotë, ti e ke me vendim këshilli, domethënë e ke shqyrtuar. Thjesht, këtë formal, këtë formalitet ka. Nuk është se u bën këto të gjitha, mund të mos bëhen. Mund të bëjnë disa, mund të mos bëjnë edhe fare nga ato, se varet nga buxheti. Kështu që isha dakord ta miratoj këtë pjesë, mos e prishni sot në ditën e fundit të vitit të ri. Ta votoni thoni edhe këtë.

Lulëzim Hoxhaj: Në emër të Komisionit të Bujqësisë, tani se unë do t'i them tre fjalë sepse u diskutua me seriozitet në komision, projekt buxheti, që do hidhet sot për votim. Mendimi, mendimi edhe mendimi personal, është të flasim tamam realisht me fjalë është një buxhet i balancuar. Por është disproporcional me, si të themi, me prioritetet dhe me atë që ka bashkia. Po të flasim për bujqësinë, meqënëse komisioni do të një pa një çik më hollë gjërat. Po të flasim për bujqësinë, ka arritje në këtë buxhet dhe rritja është e konsiderueshme rreth tridhjetë milionë lekë të reja shkojnë për kullimin për në tërësi me fjalë, por po të shikosh prioritetet që ka dhe që duhet të ketë Bashkia e Maliqit mendojmë që ky buxhet duhet të forcohet dhe duhet ashtu në këtë zë. N Kjo është ideja me të dhe kjo ishte edhe ajo që e komisionit nuk po hyn në detaj, sepse aty u fol dhe u tha që për kullimin duhet të ketë më shumë të ketë më shumë lekë dhe fonde të konvertuara këto me naftë dhe me ato kapacitete që ka bashkia, me fjalë të ketë më shumë. Është prezent në sektorin e kullimit, sepse është kryesor me fjalë, edhe në vaditje ka shumë vetë anëtarët e komisionit të bujqësisë. Nuk ka rëndësi majtas djathtas për të. Ishim të gjithë të një mendimi, një zëri me fjalë. Kanalet vaditëse sot, pavarësisht se mund të jenë dhe të reja, janë bërë dy, tre vjet përpara. Nuk e di. Por kanë nevojë për riparime, kanë nevojë për mirëmbajtje dhe duhet një fond më i konsiderueshëm për mirëmbajtjen e këtyre. Dy gjëra me fjalë u trajtuan dhe doja t'i thosha edhe në emër të komisionit me fjalë. Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, mund të të lutem, mund të shpjegoj diçka, se ndoshta më kishit kërkuar dje që të isha pjesë e komisionit të bujqësisë, po nuk isha prezent. Pasi isha në një takim tjetër, dua të sqaroj një moment. Nuk është se s'ka ujë, edhe pse ka nevojë për rritje të kapaciteteve për efekt ujitjes. Në konceptin tim, dhe unë besoj do të bie dakord me një pjesë të konsiderueshme tuaj që merren me bujqësi, kemi një keqmenaxhim të shfrytëzimit të ujit për vaditje. Në pjesën më të madhe, mos them nëntëdhjetë e pesë për qind e vaditjes në fushën e Maliqit, bëhet me përmbytje. Me përmbytje, nuk mund të ujiten baçat e mollëve, sikur t'i kthesh lumin Devoll, jo në atë kohë që aq ka. Por t'ia kthehesh kur është në maksimum, nuk e, nuk e mund ta mbytësh dot fushën e Maliqit. Ndaj, dhe duhet të filloj të ndryshoj vizioni. Edhe i joni, por dhe i fermerëve veçanërisht ata potencialë për të kthyer vaditjen me pika projekti që ne kemi bërë. I fundit që po e çojnë për financim për ujitjen me pika në zonën e Pirg-Leminotit. Ne mendojmë që do të fillojë ta kursejë ujin dhe të ketë vaditje nga tre apo katër që bëjmë tani. Të bëjmë shtatë, tetë e sigurt. Por ama, duan t'i çojmë Saraqineskën në krye të çdo parcelë me sat individual, që të ketë mundur dhe ai të dijë ç'paguan, por të ketë ujë pa ndërprerje. Dhe në qoftë se ne edhe pse kjo kërkon patjetër investime shumë të mëdha, bonifikimi dhe ujitja e fushës së Maliqit nuk është një fjalë goje. Por menaxhimi i ujit të ujitjes ngelet problem për të gjithë ne. Bile kemi qenë transparent, kemi qenë të hapur me fshat. Pjesën e fermerëve që hajt të bëhemi palë për ta menaxhuar bashkërisht ujitjen e tokave. Pasi ne i dimë ku i kemi rezervuar, ku i kemi ngastrat, ku i kemi mbjelljet. Një stacion pompimi kemi bërë në Pojan. Edhe kanë ndryshuar gati pesëqind hektarë me një mirëmenaxhim që e bëjnë ata fermerë që janë atje bashkë me ne. Po po të bëhet kjo kudo, unë them do të shtohet uji, a duhen kapacitet e shtesë? Patjetër, patjetër duhen dhe ka ardhur koha. Që nga ajo e elektrifikimit që tha ai për fusha për puse, që nga zona të cilat duhet të bëhen pilot, si kjo i duam të bëjmë në Leminot-Pirg. Për të përmirësuar këtë punë, por investimet që ne kemi hedhur këtu në fushën e ujit të kullimit fillojnë kërkojnë një peshë më të

madhe, që është stacioni i pompimit në Maliq dhe në Orman. Skema ujitëse e Leminotir në Pirg. Ushqyesi i rezervuarit në Leminot dhe në Klocë për të rritur sasinë gjatë periudhës së dimrit. Betonim kanali i ujit të rezervuar Podgorie, që mos kemi rrëshqitje në atë zonë dhe në zona të caktuara, ne të çojmë ujë atje shtesë, etjera, etjera. Nejse, faleminderit.

Ornildi Demollari: Po, Server.

Server Xhuti: Faleminderit, kryetar. Kisha disa pyetje për kryetarin, ujërat e zeza. Kryetar, një e kemi edhe fushën e sportit, dy. Ai ke planifikuar gjë prej dikujt?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Sapo kemi mbyllur një projekt për ujërat e zeza në fshatin Zvezdë, është një fshat problematik. Jemi duke mbyllur projektin e ujësjellësit, i cili shumë shpejt është bërë provë e parë. Edhe Zvezda të ketë ujë pa ndërprerjen 24 orë. Pavarësisht disa problematikave të vogla, disa shqetësimeve të banorëve, disa prishje të rrugëve të trotuarve të tjerave. Sfidë për ne tani ngelet vërtetë ajo që thoni ujërat e zeza, pasi projekti që është realizuar shumë vite më parë i derdh ujërat e zeza në kanalet poshtë fshatit, duke krijuar një situatë shumë shumë të vështirë. Ne patjetër, ne po mundohemi, po e shikojmë disa drejtime dhe projektin e kemi bërë të ndarë me nënobjekte. Pasi vlera është e konsiderueshme, përsëri do të shkojmë tek ujësjellësi i Korçës, i cili menaxhon tani ujësjellësat për ta çuar si financim të radhës projektin, e kemi mbyllur. Po të duash, mund të ta tregoj në një moment. Jo, jo, e kam për këtë projektin e ujërave të zeza për të marrë një ide se edhe ajo kërkon disa zona ku do të trajtohen ujërat, se edhe ne s'mund t'i derdhim. Kërkohet një, janë hedhur disa ide për të bërë ato dhomat e dekantimit të filtrimit e të tëra. Pasi ky është problemi i madh, bëjmë kanalizime dhe ia derdhim njëri-tjetrit në parcelën te kanali. Megjithatë, kemi hyrë ç'ka, po rrugët nuk kemi asfaltuar, se duhet të bëni ujësjellësin. Tani qoftë. Pa pra, ky është projekti i radhës, të cilën sapo e kemi mbyllur projektin, të shpresojmë ta financojmë këtë vit që vjen. Se do të çdo të shtrojmë asfalt, do fillojmë ta çajmë prapë, edhe nuk. Fusha e sportit do ta shikojmë, bëre shumë mirë që ma kujtove, ta shikojmë në linjën e projekteve që ne duam të realizojmë. Okej.

Ornildi Demollari: Pranvera, Nersida, pastaj Yllsoni.

Pranvera Begolli: Aktualisht, kryetari i komisionit i dha të gjitha çfarë thamë neve atje. Një buxhet i konsoliduar. E pante strukturën dhe punonjësit do të jenë të përgjegjshëm edhe vetë për punën që kryen, se sa e realizojnë atë punë në bazë të pagës. Kryetar brenda atij buxheti është dhe një fond për ne këshilltarët, që aktualisht miratojnë struktura, miratojnë paga, miratojnë tërë procesin e punës administrative. Buxheti i këshillit të radhë na është ulur nga pesëqind mijë që ka qenë vitin e kaluar. Si vit na e keni vënë dyqind mijë?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jo, jo, fondi nuk ka ndryshuar aq sa që ka qenë.

Pranvera Begolli: Dyqind mijë sikur ishte.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Fondi, është sa ç'ka qenë, është përsëri, por kjo s'do të thotë që ju. Për mirëmenaxhimin e këshillit, për t'u trajnuar sa më mirë, për të marrë eksperienca, harxhoj mezi harxhuat këtë vit. Harxhojini pastaj këtu jemi, pas tjetrës i shikojmë.

Yllson Ibrhhimllari: Unë jam i mendimit ta heqim fare, për kaq performancë sa ka ky këshillë, duhet ta heqim. Të vijmë, të vijmë për komunitetin në mënyrë vullnetare. Tani të lutem te prioritetet, kisha diçka. Po, ndërsa po bëhesh diversion, e pastaj më akuzoni mua për diversion.

Neresida Shindo: Kryetar për fshatin Rrëmbec, kisha diçka siç ishte edhe Zvejza. Problemi kryesor i fshatit Rrëmbec janë ujërat e zeza, gjithashtu dhe një fushë që është për të marrë shembull në rehabilitim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Tani nuk mund të realizojmë kanalizimet e ujërave të zeza në çdo fshat. Midis tyre, i njëjti problem është edhe për rrëmbecin, prefekt të pjerrësisë, që kanë këto fshatra për ujërat dhe për t'i çuar ku t'i çojë, nuk ka. Përqindje të lëvizjes së ujërave, ndaj edhe ne. Këtë vit, këtë vit mendojmë që kemi rënë dakord, se në qoftë se s'do kishim rënë dakord, do ta kishim parashikuar në buxhet blerjen e një mjeti bot, për heqjen e ujërave të zeza, siç ka qenë më parë, themi po u mundojmë në dy projekte. Një projekt e kemi me bashkinë Pustec, që ata kanë një mjet. Dhe në bashkëpunim me njëri-tjetrin do ta marrim për ta trajtuar derisa të marrim një mijë tonin dhe një me Agjësinë kombëtare të mbrojtjes civile, me të cilën kam kontaktuar edhe me ministrin edhe me drejtorin, që këtë vit do të na i parashikojnë. Ne e kishim kërkuar që vitin e kaluar, por gabimisht nuk na u lla botë, po na u dha borë pastruese, jo se ajo nuk na bën punë. Dhe të shpresojmë që problemi juaj, po që s'është vetmi juaj, është Pojani, është Sheqerasi, është gjithë zona e fushës që nuk ke mundësi. Ti i çosh gjëkundi, se mbeten atje.

Neresida Shindo: Jo, dhe një botë do ishte shumë mirë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po, po, patjetër do ta realizojmë.

Neresida Shindo: Edhe fusha, fusha e sportit. Le shumë për të dëshiruar, kush na ke një shumë të mirë, shumë të mirë e kemi, por do mirëmbajtje e do rrethim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është e vërtetë, faleminderit. Është një nga fushat më të mira në territor, kjo është e vërtetë.

Yllson Ibrhhimllari: Meqë ne fjalën tonë e përfaqësoi nënkryetari i këshillit dhe një prej kryetarëve të forcave politike të koalicionit. Unë do të jem konçis dhe pa ju ngrënë më shumë kohën, kryetar. Do të mendoja që në prioritete të vendosnit dhe është shumë emergjente. Rruga nga Vreshtasi deri në Rrëmbec, ose ajo e quajtur Rruga e Fushës, që do të ndihmonte shumë fermerët e kësaj zone për kontributet dhe një tjetër shtesë, po kjo jo individuale, meqë arkitekti i rrugës nga Moglica në Zerece në Skrapar momentalisht ndodhet me privim lirie. Që mos na vijë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ SEKRETARIA

dhe ne në të ardhmen, ai rast mos e paçim atë gjë. Besoj që duhet të vini në prioritete për ta shpëtuar atë si zonë. Edhe rrugën nga tri ura deri te guri i kamjes, një rrugë rurale që mund të mbledhë dy bashki për dy aspekte. Pavarësisht numrit të vogël të banorëve, po mund të flisni me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, që Skrapari kur vjen që andej të shkojë në Qukës direkt dhe s'ka nevojë të vijë në Maliq. Pjesa tjetër, ajo Mesmalit, ti e di që është gangrenë. Sa herë vënë të bën takime, ajo rruga e Mesmalit është e tillë. Pjesa tjetër dhe më shumë elementare është që ndodhemi dhe kthehemi në një zonë turistike shumë të bukur. Ju lutem, Ilir. Kthejmë një zonë turistike, e cila do të bashkonte dy kishat më të vjetra të zonës. Kishën e Tudasit, që është kisha, pavarësisht se s'na përket ne, po është gjeografikisht shumë afër me këtë zonë. Që është kisha ku është varrosur Kirana Muzaka ose nën nën daja e Donika Kastriotit dhe kisha e vjetër e Niçes, e cila është kisha më e vjetër për e vjetër armene në Ballka. Kisha më e vjetër armene në Ballkan, ndërkohë që mund të flitesha edhe me mikun tuaj, Zotin Xhakolli, dhe për shpinë muze të kutelëve në Niç dhe bënte një transksion.turistik të luginës, aq të tillë, siç duket, duke lexuar pak kohë, edhe në respekt kryetarit të këshillit bashkiak për gjithë mundin që ka bërë, edhe prioritetet e Planit të zhvillimit të PPV-së të miratuar, ju që në dy mijë e njëzetën e keni parashikuar edhe. portin e moleve të varkave në Liqenin e Moglicës, pra kjo rruga që do të bëni anës liqenit, që do të bënte atraksion turistik. Të kishte të çonte edhe një vend për të lidhur varkën, ndoshta Luli ose niprit e lulit, kur t'i vijë radha për t'u bërë. E treta pavarësisht arkitekturës së lartë mendore dhe zhvillimit shumë të madh në pjesën ekonomike të Zotit Kupe edhe zonjës Vera, që iu mbajnë atë komision të financëve aq mirë dhe me aq integritet, besoj që Zoti Kupe më mirë t'ia lërit Idlirit atë pjesë të këtyre riparimit të banesave, kemi një komision për këto banesa të komisionit të trenit. Sigurisht, nuk kam dyshime të tilla. Ju faleminderit. Dhe sa për diversion, çdo projekt që do vijë nga ish-kryetarja e grupit të mazhorancës dhe nga kryetarja aktuale e ka votën time dhe mund të merrni minutat e mia kur ato të flasin. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, po faleminderit.

Pranvera Begolli: Aktualisht desha të ngrija një problem që për mua është ç'gë ngre në qytetin e Maliqit. Të vesh në Korçë ka një parkim, ku marrim dhe një tarifë që hyn atje. Ne shkojmë në një supermarket që ka qyteti jonë dhe për çudi të gjitha makinat marrin gjobë. Më mund të rish dhjetë minuta të marrësh diçka, se vjen policia të vë gjobë. Pra, do desha qytet Maliqit që kishin parking dhe për invalidët. Që të kenë një të vetëm të të vijëzuar dhe ne të krijojmë të ardhura të marrim, mos e kemi pesëdhjetë lekë, se ai ka kusht dhe kemi tridhjetë. Të gjendet një vend ku e mund të parkohen e mund të rregullohen.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Jam shumë dakord me propozimet, bile i surprizuar me propozimet e Yllsonit për investimet prioritare. Domethënë, se edhe ne kemi nevojë për idetë e njëri-tjetrit. Patjetër, duhet t'i përfshijmë dhe ia propozoj t'i futim në projektvendimin përkatës të investimeve prioritare. Shumë interesante, bile një nga rrugët, ajo që mendohet të lidhë Gjinikasin me zonën e Gjon Babasit të Lekasit, është propozimi edhe i Bashkisë së Korçës. Dhe po synohet që ajo rrugë mund të jetë rrugë më e mirë në dimër për Lekasin se sa për ne, pavarësisht se na shërben edhe ne. Dhe ata kanë filluar negociatat me Fondin Shqiptar të

Zhvillimit për ta trajtuar si rrugë lidhëse. Veçanërisht në periudhën e dimrit, por ajo është më e shkurtër po ta marrësh, edhe me investimin e mirë që u bë rrugës së Lozhanit. Do ishte një fantastike edhe për zhvillim, po të marrim aty edhe një zonë rreth pesëqind hektar, që është një kishë e madhe dhe një gadishull, themi, e cila mund të shërbejë edhe si park gjuetie me pagesë të themi, do ishte një gjë shumë fantastike. Kështu që jam shumë dakord sa për atë që thotë Vera. Unë mendoj që ne mund të krijojmë të ardhura dhe mund të vendosim edhe parkim me pagesë në qytet. Po ishte kjo propozimi jot, por qyteti jonë ka qenë më i lirë. Dhe ne kemi menduar që ky qytet le të gumëzhi edhe nga makinat, edhe nga njerëzit, edhe nga të tjerat. Por nuk jam që policia të mos bëjë punën e tij. Nuk mund të rrijë makina në kryqëzim. Pse do blerë dikush njeri para një lokali, para një dyqani, kur dhjetë metra apo pesëdhjetë metra larg asaj kryqëzimi ke njëzet vende parkimi që rrinë bosh. Po duash ta tregoj edhe ku është rruga që është bërë në drejtim të lozhanit. Ka të paktën njëzet parkime, por në qoftë se ne jemi mësuar që duhet të rrimë në derën e dyqanit. Ose e fundit, në qoftë se lejohet në mënyrë nga se nuk marr vesh shumë nga pjesa e qarkullimit rrugor. Supermarketi në fjalë, po jo vetëm ai, por dhe supermarketet e tjerë, siç bëjnë të tjerët, mund të marrin pagim me pagesë. Ne ju japim, u vendosim tabelën, edhe qytetarët vend blejnë, se ai për interesin e tij e bën, nuk e bën për interesin tonë. Shumë faleminderit.

Almir Elezi:Të pyeti doktori edhe për rrugën Vreshtas.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po ashtu, prioritet edhe ne kemi patur, kemi dhe projekt për të. E kemi futur në projektet e Bankës Botërore, pasi është një investim shumë i madh dhe shumë i rëndësishëm, shumë i rëndësishëm. Me rënien e fushës për efekt të urave të djegies, ajo është ende është bërë problem, edhe pse ne kemi ndërhyrë në disa ura që kemi prerë, i kemi ribetonuar. Prapë ka nevojë. Do ishte një gjë shumë fantastike në qoftë se do realizohej. E patjetër do ta futim në.

Ornildi Demollari: Ju lutem, e kalojmë në votim pikën gjashtë.
Kush është dakord? 21 vota pro
Kush është kundër? Shtatë me njëzet e një vota pro dhe me shtatë kundër miratohet. Yllson Ibrahimllari, Nersida Shindo, Lulëzim Hoxhaj, Marjeta Xhelollari, Albina Xhejo, Servrer Xhuti, Faslli Zholi, Unë mendova se pas rrezymesë që i bëri doktori, do kthejej. Faleminderit, miratohet. Kalojmë tek pika tjetër. Kalojmë tek pika shtatë e rendit, po. Kalojmë tek pika shtatë e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e listës. Të investimeve prioritare të Bashkisë Maliq për vitin dy mijë e njëzet e gjashtë, komisioni i financës përsëri.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po atëherë diskutuam, po të shtojmë këtu,

Petrit Kupe: Prioritaret u shtuan. Vetëm hidhen në votë, se unë, kryetar, bashkë me shtesat që u provova. Bashkë me shtetet e doktorëve, vetëm një gjë që kisha unë do isha dakord që të hiqej në vitin të ardhshëm rruga e Kolanecit nga prioritarët.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Shiko, ne po synojmë dy rrugë që u thashë, edhe Kolanecin, edhe Strelcën i kemi çuar projekt edhe në Fondin Shqiptar i Zhvillimit për efekt të këtyre zhvillimeve zonë turistike. Pasi në qoftë se do ta financojmë vetë një nga këto rrugë, është gjithë buxheti i investimit që ne bëjmë. Kështu që kush do të na i falë, ose kushdo që tjetër prej jush të vijë këtu në vendin tim, nuk besoj se do bënte një rrugë e të linte njëzet rrugë të tjera. Kjo është me pak fjalë, po jo se s'duam ne. Buxheti ka nevojë gjithmonë për po asnjëherë një kryetar bashki apo një këshillë bashkiak nuk mund të thotë që kemi lekë dhe nuk dimë ç'ti bëjmë. Kur ka shumë halle, shumë probleme, shumë çdo ditë dalin.

Ornildi Demollari: Atëherë, tek pika shtatë, ka ndonjë koment tjetër? E kalojmë votimin, ju lutem, pikën shtatë?
Kush është dakord? 27 vota proa
Kundër? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka, me njëzet e shtatë vota pro. Miratohet faleminderit dhe kalojmë tek pika tetë. E rendit të ditës, që është projektvendim për miratimin e programit buxhetor afatmesëm përfundimtar për harkun kohor 2006-2008.

Petrit Kupe: Po, duke mos ngrënë kohë, sepse janë prej vendimeve që miratohen vazhdimisht. Po, ky është përfundimtari. Jam dakord që dy pretendimet miratohen për njëherësh si teta dhe nënta janë parashikime buxhetore.

Ornildi Demollari: Më mirë, o një nga një, pse?Atëherë, teta, kush është dakord? 27 vota pro
Kundër? Nuk ka
Abstenim? Nuk ka, miratohet me njëzet e shtatë vota pro. Kalojmë tek nënta. Miratimi i kalendarit për programin buxhetor afatmesëm për vitet dy mijë e njëzet e shtatë, dy mijë e njëzet e nëntë, edhe vjetori i vitit dy mijë e njëzet e gjashtë. E kalojmë votim, ka ndonjë?
Kush është dakord?27 vota pro.
Kundër? Nuk ka.
Abstenim? nuk ka, miratohet me njëzet e shtatë vota pro. Dhe kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e bursave të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe arsimit profesional për vitin shkollor dy mijë e njëzet e pesë, dy mijë e njëzet e gjashtë.

Neresida Shindo:Në lidhje me komisionin e miratimin e bursave të arsimit të mesëm dhe të përgjithshëm, gjithashtu dhe këtij profesional, neve dua të falenderoj gjithë komisionerët, sepse dje për herë të parë zhvilluam një bashkëbisedim dhe mbledhje online, e cila rezultoi shumë e suksesshme. Falenderoj Fazlliun, Gentën, Lulin dhe Danielën. Kemi diçka rreth bursave të arsimit profesional, gjithashtu dhe atij të përgjithshëm. Doja të pyesja a ka mbetur nxënës pa u trajtuar nga këto bursa? Ose ka përjashtime?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Janë trajtuar të gjithë kërkesat me bursë të nxënësve. Kishim një problem midis numrit të miratuar nga Ministria me kërkesat. I mbyllëm duke i mbuluar me fondet tona. Është bërë akordimi dhe të gjithë do marrin bursë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

Neresida Shindo: Okej, faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk është parë të gjithë kërkesat, nuk janë parë. Nuk është parë as si e ka emrin. Pasi e quajnë emrin e babait, pasi e ka mbiemrin, po janë parë kriteret dhe baza ligjore që u takon.

Neresida Shindo: Dhe për nxënësit e lozhanit. Çfarë është vendosur? Të cilët kishin një rrugë, një distancë rrugë, rastësisht për komisionin tonë mund të ishte në ndihmat.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk di të them çfarë ka nga një projektvendim i parë që ka marrë Këshilli i Bashkisë. Duhet ta, duhet të arrijë. Rishikoj për t'iu kthyer një përgjigje zyrtare dhe të saktë, që mos po.

Specialist i Zyrës të Arsimit në bashki; z.Florenc Muçollari:Përshëndetje të gjithëve, atëherë është një pjesë e këtyre studentëve janë brenda listës që janë përfitues, ndërsa pjesa tjetër janë rreth tetë nxënës, të cilët do të trajtohen nga fondi i shtesë që do të bëhet në janar.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk doja ta thosha unë pa e konfirmuar kështu që, okej.

Neresida Shindo: Atëherë ne duam që të shtohen sa më shumë nxënës që kërkojnë të shkollojnë në shkolla sa më të mira, siç janë ato të Korçës, të cilët shkojnë. Por gjithashtu do do doja që edhe ne në shkollat tona të kishim një investim që t'i mbanim nxënësit të. Vazhdonin shkollën në gjimnazet përkatëse, siç është pirgu Pojani, dhe mos të na shkoni në të qytetit të Korçës. Kaq, kisha faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Patjetër, megjithëse unë mendoj që ne çdo vit po financojmë, po investojmë në shkollat tona. Ka nevojë, patjetër. Por ka ardhur koha edhe rigrupimi i shkollave pranë shkollave, të cilat japin edhe janë dhe specialistët, se mund të mbajmë një klasë kolektive në një fshat. Nuk po them të gjitha fshatrat, se po flas për gjëra që s'kanë lidhje me mua. Genta mund të jetë. Jo mund të jetë po ajo është pjesë e kësaj pune, adap edhe mund ta japë një përgjigje të saktë, por Ministria e Arsimit, edhe në bazë të kërkesave tona, ne po mundohemi të financojmë dhe të bëjmë projekte për të gjitha shkollat, veçanërisht ato të mesme të përgjithshme, ku numri është më i madh dhe ka një sens për investime të tilla ne kemi sapo kemi realizuar një projekt për shkollën e mesme të Maliqit. Për shkollën nëntëvjeçare të Maliqit, për shkollën e mesme të Sheqerasit, ku investimet, nuk ka ndodhur prej vitesh dhe ka nevojë për efekt jo vetëm të numrit të madh të nxënësve, por dhe për të një ri formatimit të të të gjitha ambienteve të tyre, ta quajmë me ngrohje qëndrore e tjera, që iu mungon këtyre shkollave. Po them, shkolla e mesme e Maliqit dhe e Sheqerasit, të cilat kanë nevojë për ngrohje qëndrore. Dhe larg ta zëmë, po themi, ngrohjes tradicionale me dru zjarr.

Neresida Shindo Dhe diçka se m'u tërhoq vëmendje, se mos harrova gjimnazin e rrëmbecit. Nuk e harrova, por ne biseduam edhe me Gentën. Shkolla duhet të kenë programe shumë të mira që të

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA MALIQ

kërkojnë edhe investim nga ministria, sepse nuk besoj se kjo varet vetëm nga buxheti i bashkisë. Duhet të ketë programe shumë konkurruese me shkolla të tjera, që ato ta fitojnë, Laboratore, laboratore, është e vërtetë, është e vërtetë. Të informatikës, faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit. Kemi gjë tjetër atëherë? E kalojmë votim. Ja një moment, do votosh apo do flas?

Yllson Ibrahimllari: Do flas, po. Atëherë është vjet kemi shtuar me kryetarin një listë të nxënësve. Ndoshta edhe ishte ai momenti kur nuk ndodhesha në sallë. Ju kërkoj të falur. Të disa nxënësve në zonën e Selcës dhe të Mesmalit për disbursimin e largësisë. Megjithatë, unë i riparimit të parë, ça sjelli Genta miratohet? Faleminderit.

Ornildi Demollari:E kalojmë në votim, ju lutem? Bursat e arsimit të mesëm dhe profesional, Kush është dakord kundër? 27 vota pro.
Abstenim? Nuk ka.
Kundra? Nuk ka. Miratohet me njëzet e shtatë vota pro, suksese nxënësve të këtyre shkollave. Kalojmë tek pika dhjetë e rendit të ditës. Njëmbëdhjeta, më fal se i kisha të ndara. Projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fundit për muajin nëntor dy mijë e njëzet e pesë. Këtu, tek ndihma ekonomike, Florenc, ju jeni përfaqësues apo Johana ka erdhur dhe një kërkesë që është. Për ju, desha ta lexoja dhe t'ia prezantoj edhe këshillit. Dhe t'ua këshillit të bashkisë, kryetarit të bashkisë e zyrës së ndihmës ekonomike, unë Sokol Rungo. Banori i fshatit Sheqeras, njësi administrative Vreshtas, me anë të kësaj kërkese, dëshiroj t'ju informoj dhe t'ju lutem të rishikoni situatën time familjare dhe vendimin e ndërprerjes së ndihmës ekonomike. Ndihma ekonomike e familjes sime është ndërprerë pasi djali im u martua, ndërkohë që ne si familje romë e parsimim nuk kemi qenë të njohur me rregullat dhe afatet e deklarimit. Për shkak të mosinformimit dhe pa ndonjë qëllim të keq, jemi penalizuar për gjashtë muaj, gjë që na ka futur në një gjendje shumë të vështirë ekonomike. Dua të theksoj me respekt të madh se punonjësit e ndihmës ekonomike gjithashtu na kanë këshilluar si duhet për ne. Për shkak të nivelit të ulët arsimor, i kemi kuptuar me vonesë procedurat dhe kërkesat e sistemit. Familja ime përbëhet nga gjashtë anëtarë dhe jetojmë në kushte shumë të vështira. Shtëpia jonë ka vetëm një dhomë gjumi dhe një kuzhinë të vogël. Dhe është në gjendje të degraduar. Ndihmën ekonomike e përdorim kryesisht për të paguar energjinë elektrike dhe ujin. Aktualisht, pa këtë mbështetje, gjenda jonë është bërë tepër e rëndë, sidomos me afrimin e dimrit. Ju lutem në mirëkuptimin e situatës tonë të vështirë dhe faktit se penalizimi erdhi për shkak të mosnjohjes së rregullave. Kërkoj me respekt që të rishikohet vendimi dhe të na rikthehet ndihma ekonomike sa më parë. Gjithashtu, nëse është e mundur, kërkoj që Këshilli Bashkiak të na mbështesë me çdo mundësi tjetër ndihma ekonomike, pasi familja jonë ndodhet në kushte të vështira. Me shpresë në mirëkuptimin dhe një zgjidhje të shpejtë, ju falenderoj paraprakisht.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po nuk besoj se ne, nuk besoj se ne mund t'i bëjmë gjë në lidhje me atë që është penalizuar, se e ka penalizuar sistemi. Por ajo që ne mund të bëjmë është që të shikohet nga zyra dhe nëpërmjet këshillit që të paktën, të shikohet si familje, nuk dua të, se

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

kam me këtë, e kam edhe me, bile, i bëj apel zyrat që të jenë të kujdesshëm në momentin kur dikush nuk ka firmosur, kur që e dinë që është, po patjetër duhet të jetë ky referimi. Megjithatë, rasti në fjalë që mos shpërndahem është që duhet parë për ndonjë ndihmë financiare që Këshilli i Bashkisë mund ta trajtojë. Edhe kjo familje me gjashtë persona e tillë ta u ta gëzojë vitin e ri, si gjithë familjet e tjerë. Shumë faleminderit.

Ornildi Demollari: Faleminderit, atëherë po.

Faslli Zholi:Është e vërtetë që ne e diskutuam këtë kërkesën me ekzekutivin. Ishte vajza që ka dërguar përfaqësues ata. Po, ai kishte atë defekt të çetftikatës që nuk ishte paraqitur mbas kriterit. Ai është gabimi, mosnjohja e ka harruar, as që e ka bërë. Mund të gjejmë një rrugë ku si mund të ndihmohet. Neve jemi. Të japim një shpërblim dhe të aplikojë se e drejta nuk i promovohet atij atij se ta bëjë këtë, po që këtë ky problem doli, jo se është të lënë pas dore ajo familje. Kurse për të tjerat, jam dakord ta votojmë ndihmat ekonomike.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Do propozoja t'i japim dhjetë mijë lekë, që të festojë vitin e ri.

Lulëzim Hoxhaj: Ti bëjmë 20.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Okej, dhjetë unë, dhjetë bëj njëzetë mijë lekë që të festoj vitin. Okej. Megjithatë, duhet parë rasti, nuk e kam vetëm për këtë rast, se duhet të jemi duhet të jemi objektivë për këtë punë që ka bërë ndarje fiktive. Sa është mosha e atij që ka ndarë, është i martuar, është i martuar që edhe ai të kuptojë që si duhet vepruar, se hapim ndonjëherë precedent edhe për të tjerë që penalizohen, edhe nuk kemi çfarë t'ju bëjmë.

Ornildi Demollari: Atëherë kemi gjë tjetër për projekt vendimi në tërësi? Njëzet, njëzet, po për projekt vendimi në tërësi, kemi gjë tjetër? E kalojmë në votim duke duke shtuar edhe ndihmën financiare për njëzet prej njëzet mijë lekësh të reja.
Kush është dakord kundër? 27 vota pro.
Abstenim? Nuk ka.
Kundra?Nuk ka.Me njëzet e shtatë vota pro miratohet. Dhe faleminderit, kalojmë tek pika. dymbëdhjetë e rendit të ditës, që është projekt vendim për dhënie ndihmën financiare për familjet në nevojë. Mund ta kishim. Po mund të shtohet edhe familja, po patjetër, po patjetër, po ka ndonjë pyetje këtu ose ndonjë koment?

Prnavera Begolli: Aktualisht unë jam që t'i jepen ato ndihma, sidomos për familjen që e kam aty, të Lulëzime Shkëmbit për problemet që ka në familje, i ndodhi një procedurën me djalin e madh, kështu që falenderojmë për mbështetjen e këshillit që ato lekë t'i kalojnë në ndihmë asaj familje, sepse janë vërtetë në nevojë.

Ornildi Demollari: Tjetër kemi gjë, atëherë tek kjo pikë shtojmë edhe familjen e Zotit Sokol Rungo. Me njëzet mijë lekëshin kemi gjë këtu, e kalojmë votim. Kush është dakord? Dakord, edhe kundër nuk ka, abstenim nuk ka. Me njëzet e shtatë vota pro miratohet edhe kjo pikë. Faleminderit. Të kalojmë tek pika trembëdhjetë e rendit të ditës, projekt vendim për dhënien ndihmë financiare për familjen e Zotit me inicialet G.B. Banues në fshatin Zvirinës, i Administrativë e Pirg, banesa e të cilit u shemb si pasojë e përmbytjeve të muajit të datës njëzetë nëntor dy mijë e njëzetë e pesë. Po.

Yllson Ibrahimllari: Atëherë është paraprakisht, sepse duket tashi që ca janë bujarë, edhe ca janë kurrnacë në këtë këshillë. Paraprakisht, po po krijojmë një precedent që do të thotë kemi një territor të tërë të bashkisë, i cili është përmbytur. Dhe e vendosim tek një material shtesë që na vjen si informacion nga bashkia. Po flas në parim, s'kam asgjë personale. Ky zotëria familja e kësaj, kjo familje do ta marri këtë shpërblim, këtë vlerësim e tjera. Por unë po shikoj në pak listën e këtyre vlerësuesve këtu. Kur i marr për të vlerësuar ndonjëherë ndonjë gjë andej nga më ndodhin mua ca probleme, më thonë nuk jemi specialistë, ne nuk firmosim, ne nuk bëjmë ne. Na vjen këtu një listë e tërë. Vlerësimi dhe na vijnë për shtëpitë e djegura. Na vjen një lavatriçe me gominë dhe një lavatriçe pa gominë. Na vjen këtu në projekt dhe ne e marrim, e ngremë kartonin edhe e miratojmë. Tani ta ndajnë këtë zotërinj që përgatitin raportet. Po janë specialistë dhe janë për të gjitha gjërat, edhe kur mbytet Serveri në Zvezdë, edhe kur mbytet shtëpia në Zvirinë, edhe kur mbytet Luli atje ku e ka shpinë, ose të thonë, ose të thonë, dakord, më shumë që radhët e Petrit. Të falenderoj për vëmendjen, po besoj që ia di shpinë lulit.Këta zotërinjtë, o janë specialistë, o rekrutojnë specialistë dhe i thërresin specialistë të fushave që të marrin të vlerësojnë. Përgjegjësi i sektorit të emergjencave civile, specialist juridik, drejtoria e financës, konceptoi Filan Fisteku se s'po marrim emra e tjerë. Në qoftë se nuk janë specialistë as të vlerësimit të dëmeve nga zjarri, as të vlerësimit të emergjencave civile, mos na i sjellin ne projektin. Ta kalojnë atje ku janë specialistët, të marrin raportet e specialistëve dhe pastaj të na i sjellin. Paraprakisht, unë dhe kam mirëkuptimin e kolegëve të të dyja palëve që kjo familje e meriton këtë shpërblim që po japim. Po japim dhe po bëjmë gjëra fiktive. Dhe po diskutojmë raporte. Vajti dikush e pa. Ai është në gjendje të keqe ekonomike. Vajti dikush atje. Ajo shpija ishte dëmtuar. Po kur erdhi puna te Kadiu? Kadiu e nxorri qitapin dhe tha, kjo është e Kadiut, tha, kjo është e Arefiut. Ndjesë pas tim atë është quajtur kështu. Tani problemi është kështu, tha. Kemi kaluar në rendin e ditës një projekt vendim për një familje që meriton tërë vëmendjen dhe kontributin tim individual, që gjej rrugë dhe mënyra për t'ia çuar. Dhe nuk kalojmë të. Si projekt falë fjetjes së dy përfaqësuesve të opozitës në kryesinë e këshillit fjetjes gjumë në takimin që keni bërë si kryesi e këshillit, pa e ngritur problemin fare. Gjithë bashkia e Maliqit ka qenë nën ujë dhe i vetmi që ishte në punë ishte kryetari i bashkisë. I vetmi që ishte në punë, po e ritheksoj, ishte kryetari i bashkisë. Dy këshilltarët e opozitës që kanë mandatin tonë për të diskutuar gjërat nga opozita. Për të ngritur zërin tonë tek kryesia që keni mbledhur dhe shumë mirë që e mblodhët kryesinë për të marrë vendime, nuk kanë thënë asnjë fjalë, as kanë kërkuar të futet në rendin e ditës. Unë them dhe gjej rastin për të mos iu nrgënë kohën, por as për të mos e tensionuar situatën për të bërë festat. Unë mendoj që pikën që ke vënë prapë Informacion për përmbytjet, duke u nisur nga shkaku i demëve në bujqësi për ngricat e periudhës së caktuar, duke

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA MALIQ

u nisur nga shkaku i përmbytjeve. Kërkoj një mbledhje, sugjeroj një mbledhje jashtë radhës së këshillit për të diskutuar gjithë problematikat. Me vaditje, me ujitje, me kanale, me pengesa, me heqje, me i thashë, i dhashë të gjithë komisionet dhe të raportuar në nivel grupesh punësh për çdo njësi administrative. Unë nuk kam punë fare me vreshtasin. Ti kërkoj luli. Unë kam punë me Gorën. Grupi i Gorës do jetë këtu prezent. Do raportoj. Qoftë aktin e konstatimit, kryetar, kush nuk të firmos procesverbalet hiqen nga puna? Po që se thonë, nuk e firmos unë, se bëj unë, se është doktori, se është Luli, se është idliri, është tjetri të iki.. Kush ka marrë përsipër, ky është muhabeti. Ne jemi nga këshillat më të mira që ka Republika e Shqipërisë. Nuk kemi çuar asnjë në burg. Po mund t'i vijë shumë shpejt koha dhe asaj nëse nuk firmosin ose fallsifikojnë proces verbale, gati e kanë. S'ka as shantazhim, asgjë. Të lutem, nuk mund të kalojmë një vendim për një shtëpi të mbytur në zvillim me gjithë hallet që ka ajo familje dhe mos kalojmë treqind apo pesëqind familje të tjera që janë përmbytur gjatë kësaj kohe pa iu vlerësuar dëmin. Vota për këtë që keni shtruar është pro. Kërkoj dhe kam mirëkuptimin, kushdo që të jetë nga anëtarët, le ta shtrojë sugjerimin. Unë besoj mos e tensionojmë. Lini në janar një mbledhje jashtë radhë për të diskutuar dy fatkeqësitë natyrore. Një herë kur na zë akulli, e një herë kur na zë uji.

Ornildi Demollari: Ju faleminderit, faleminderit. Kemi gjë tjetër? Kryetar kishe diçka?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë, e shikoj si rast specifik. Ne kemi kërkuar materialin që ju kemi sjellë. Është parë problematika, nuk jam kundër. Bëjmë një mbledhje në janar, s'kam asnjë gjë. Që të jetë vetëm për këtë pikë, vetëm për këtë punë, se patjetër që është pikë e rëndësishme. Por ne kemi ndjekur gjithë procedurat ligjore, por rasti konkret është sikur të bjerë zjarri në një shtëpi. Edhe ne kemi trajtuar, na detyron ligji për ta trajtuar edhe këtë banesë. Që ta shikojmë në mënyrë specifike se ajo shpi, ajo familje jeton në një banesë me qira. Dhe duam që t'i japim mundësinë që ajo ta riparojë sa më parë që të ketë një mundësi. Nuk besoj se doktori është kundër kësaj pike, pavarësisht ai e pa në prizmin tjetër. Kështu që jemi ta kalojmë dhe pastaj patjetër një mbledhje në janar, kur të doni s'ka asnjë problem.

Ornildi Demollari: E kalojmë votim atëherë, pikën trembëdhjetë?
Kush është dakord? 26 vota pro.
Kundër? nuk ka,
Abstenim? nuk ka, miratohet. Faleminderit. Duke shpresuar që t'i vijmë sado pak në ndihmë me kushtet.
Yllson Ibrahimllari: Ramë dakord edhe për një mbledhje jashtë radhë.
Ornildi Demollari: Kemi kohë dhe flasim.

Yllson Ibrahimllari: Jo, mos kemi kohë, kemi karton. Urdhëroni, kush është përmbledhja jashtë? Ngriheni më njëherë kokën, se s'ju gjen gjë.

Ornildi Demollari: Po kemi kohë dhe flasim mbledhjes, ju ka s'është penguar ndonjëherë mbledhja. Sa herë që ka qenë e nevojshme, kemi thirrur mbledhjen.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

Yllson Ibrahimllari: Nga ti kam mësuar shumë bukur, e shtyra, e pështyra. Tani po, jo.

Ornildi Demollari:Çfarë do, po jo, po do ta shikojmë se kemi kohë. Kemi kohë, se sa herë që kemi pasur nevojë për mbledhje, e kemi thirrur. Nëse do jetë e nevojshme, patjetër do të thërresim edhe shumë shpejt.

Yllson Ibrahimllari: Pse ke ndonjë mekanizëm si të më frenosh për ta kërkuar jashtë radhë? E kam votat. Njëmbëdhjetë veta duhen të firmosin, thërresin mbledhjen.

Ornildi Demollari: Po nuk thashë këtë, thashë këtë apo jo?

Yllson Ibrahimllari: Pra, të thashë në fillim për mirëkuptim.

Ornildi Demollari: Miratohet kjo me njëzet e shtatë vota pro.

Faslli Zholi: Përsa i përket kësaj, po përsa i përket kësaj që kërkon doktori, mirë është ta bëjmë një mbledhje të jashtëzakonshme.Dëgjo, dëgjo, nuk e kam në këtë histori, po si kështilltar që e ngrite, bëre shumë mirë, se u tha aty që ne në kryesinë e ngritëm edhe këtë problem. E kemi ngritur dhe e kemi kërkuar, e kini brenda grupit, e diskutoni në grup, që të ecim, e diskutojmë në grup, e kemi ngritur, të jesh i sigurt për këtë, ato që i them, unë i them, dhe nuk ka. Dhe mendoj që këtë ta vendosim bashkërisht këtu, që të bëjmë një mbledhje të zakonshme, sepse ia vlen interesit të secilit që jemi këtu dhe ata që janë dëmtuar.Ta bëjmë këtë dhe faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po sqaroj diçka. Na kërkuat, na kërkuat një informacion. Për situatën e përmbytjeve, edhe pse koha ishte e kufizuar, ishte shumë e ngushtë. Ne u munduam të bënim një informacion. Në konceptin tim deri diku të hollësishëm për t'iu dhënë një situatë të asaj çfarë kishim bërë ne.

Yllson Ibrahimllari: Patjetër dhe të falenderoj, më ke bërë shumë shpejt. Po kjo kryesia gjithmonë të detyron të bësh gjëra me emergjencë. Ne themi ti, ti bëjmë ngadalë bre, të vijnë ata të tjerë, ata administratorët që marrin rrogën, ata kryepleqtë, ata banorët e dëmtuar. Faleminderit.

Ornildi Demollari: Do t'ju lutesha të shtojmë rendin e ditës dhe ju kërkoj ndjesë që, si u thashë në fillim, është një material për detajim të fondeve sipas aktit normativ me numër njëmbëdhjetë, datë nëntëmbëdhjetë i dymbëdhjeti, dy mijë e njëzet e pesë. Do të kërkojmë mirëkuptimin e kështillit ta shtojmë në rendin e ditës.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Është ai që folëm në fillim.

Ornildi Demollari:A mund ta shtojmë në rendin e ditës? Ju lutem, kush është dakord? Mund ta shtojmë kryetar, mund të na është apo e përmendi këtë? Ke diçka për të shtuar? E kalojmë në votim. Ju lutem, detajim fondi. Kush është dakord?

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIA
BASHKIA MALIQ

Kundër? Nuk ka.
Abstenim? Nuk ka. me njëzet e shtatë vota pro. Miratohet. Këto ishin projektvendimet që kishim për këtë mbledhje. Tani shkojmë tek informacionet. Kemi, kemi një, kemi një material.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të jap vetëm një informacion, ju lutem, në lidhje me. Se më ngritët herën e parë në lidhje me stacionin e pompimit në Vreshtas për vlerën e saj. Duhet të jem i kujdesshëm me ju. Vlera ka qenë gjashtëdhjetë pesëqind mijë lekë. Është vlera fituese është tridhjetë e nëntë pikë shtatë. Janë kursyer rreth dyqind e dhjetë milionë lekë. Oferta është oferta më e ulët e mundshëm për efekte dhe dua të jem korrekt në këshilltar.

Almir Elezi: Kryetar, se këtë problem e ngrita unë në media ne kemi parë 480 milionë, po ç'ka se unë e rrumbullakosa pesëqind. Jo, jo, jo. Edhe ajo do të vijë pesëqind, sepse do të bëhen kanalet. E mos e kaloj këtë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E tani po flasim për objektin. Tani kot e bëjmë këtë. Unë po ju jap informacion zyrtar, se s'mund të flasim kështu me.

Almir Elezi: Po këta të mediave, ku i marrin informacionet?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Nuk di unë tani, atij ju jeni këshilltar, ju jeni këshilltar dhe kini të drejtë të informoheni për çdo gjë. Me një kërkesë zyrtare, e ne ta jepnim zyrtarisht sa ish vlera, sa u fitua, sa u kërcënua.

Yllson Ibrahimllari:Për të të falenderuar, po e kërkoj fjalë. I risjellim vetes një mbledhje të zhvilluar nga tridhjetë e një gushti dy mijë e njëzetë e treshit. Kemi evoluar shumë bashkë të dyja palët. Atëherë do bëjmë një mbledhje jashtë radhës, do t'i diskutojmë edhe. E lamë në majë në prill, ku bëmë mbledhjen. Thamë sa të dalë edhe sythi i dytë, edhe të edhe më duken ato filmat me grackat e amerikanëve. Kur të bjerë gjethja, kur të lindi gjethja. Kjo do vëmendje publike të Këshillit për përmbytjet për të gjitha iniciativat. Më fal. Shumë dashamirëset tuaja iu drejtuat gjithë institucioneve. Duam një përgjigje. Çfarë thanë për dëmtimet e qershive, kumbullave dhe të tjerëve? Këtu ngelëm kaq fuqi kishim, kaq ecte makina. Përmbytjet e datave nëntëmbëdhjetë njëzetë grupet e punës vajtën kur vajtën. Sepse të vejë grupi i punës në datë njëzetë e thirret kryeplaku i fshatit për të firmosur në datë njëzetë e një, këtu procesverbalin ka ca historira të tjera. E kërkoj në emrin tim personal, e kërkoj në mbështetjen e grupit të opozitës. Nëse nuk e doni, sjellin firma sipas rregullores. Ju falenderojmë, ishit shumë konstruktiv.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Kryetar që ta mbyll unë, unë jam transparent, sepse transparent është vetë institucioni dhe sistemi për t'iu dhënë çdo informacion për çdo gjë që ne bëjmë në bashki. Kemi bërë shtatëmbëdhjetë procedura nga të cilat ka qenë një fond dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë lekë të reja. Janë fituar me 149 dhe janë kursyer 840 milionë lekë, që janë riformatuar për shërbime ndaj komunitetit midis tyre. Pavarësisht se investimi që ju flisni është investimi i buxhetit të shtetit dhe ato lekë i kthehen buxhetit të shtetit, nuk na ngelen ne. Do

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

ishte interesant sikur të na ngelëshin ne për të bërë një objekt shtesë, por nuk kështu e ka parë të arsyeshme ligjëvënsi.

Almir Elezi: Po mirë mo, unë e kisha në mosfunksionim.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Dua, jo, jo, jo. Ajo funksionon, funksionon.

Almir Elezi: S'funksionon se thotë që një litër ujë ka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Po ka ta heq s'ka ujë, më do t'ia jep lulit. Tani do ta dërgoj të të hapi një video, kam shkruar vetë.

Almir Elezi: Po ai desh u mbyt, më fal, desh u mbyt gabina mo, bashkë me pompat. Aq ujë pati, kishe dy skolina të mbytura. Duhet të jemi korrekt, tani të jemi korrekt. Jo, jo, jo, korrekt jemi ne. Aq prurje kishte, më the, sa dy skolinat u mbytën në Podgorie. Jo, më nuk u mbyt.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Debatin e hapa unë tani për të qënë transparent me ju dhe me publikun. Për vlerën, edhe për atë çfarë ndodh atje.

Almir Elezi: o vlerën e ke në media, nuk të kam faj unë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ore ta lutem shumë tani, po në qoftë se media.

Yllson Ibrahimllari: Po, jo, më informohet nga institucioni juaj, se nuk informohet. Ne nuk kontrollojmë mediat, ne do kontrollojmë grupet që ke çuar ti, gënjejnë apo s'gënjejnë. Ata do vijnë me një këmbë këtu.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju falenderoj, po duhet të isha transparent me ju dhe ndaj vetes time.

Yllson Ibrahimllari: Do vijnë me një këmbë, se do thoshe që ia thashë. Kjo opozitë nuk bën asnjë gjë tjetër veçse një gjë e ka pasur shumë të sigurt. Që me vullnetin tënd pozitiv, por dhe me mënyrën se si di t'i marrë, ajo ka marrë çdo informacion të mundshëm. Në këtë sens, biem dakord, do ta zgjidhim njerëzishëm e zgjidhim, ashtu e zgjidhim ligjërisht.

Ornildi Demollari: Ju lutem, ecim. Kemi një material. Jo, ju lutem, se s'kemi arritur, kryetar. Po, jo, na duhet, sepse kemi një material që thotë njoftim për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aseteve. Të aktiveve, mund ta shpjegosh diçka me këtë?

Faslli Zholi: Është informacion, janë për të hequr këtë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

Ornildi Demollari: Dakord, tani, tani jemi, jo, nuk janë me votë për votim, nuk janë projektvendimi, janë informacion. Tani jemi tek informacioni për përmbytjet. E lamë, e lamë përmbledhje jashtë shtratit. Faleminderit. Tani kemi një kërkesë, kryetar, dhe mund të largohesh. Po të qëndrosh, është mirë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Ju falenderoj shumë për mendime konstruktive, për vërejtjet, për çdo gjë që ndodh në këtë këshillë. Pasi jam për të mirën e punës, ju uroj një vit të mbarë. Edhe mbarësi për ju dhe për gjithë qytetarët e Bashkisë Maliq, shumë faleminderit.

Yllson Ibrahimllari: Edhe ne ju falenderojmë juve komunitetin dhe ndërkohë i shprehim dhe i urojmë një vit sa më të mbarë gjithë komunitetit që përfaqësojmë.

Ornildi Demollari: Faleminderit, nuk kemi mbaruar. Kemi dhe një diçka tjetër akoma, se na ka erdhur një kërkesë nga avokati i popullit. Drejtuar Bashkisë Maliq, Këshillit Bashkiak, Prefektit të Qarkut të Korçës, të nderuar. Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të urdhërit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të Të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike ka marrë në shqyrtim kërkesë ankesën e shtetasit me Mestan Myftarago. Ndaj organeve të vetëqeverisjes vendore, Bashkia Marliq dhe administratës publike, ankuesi në cilësinë e përfaqësuesit të të gjithë banorëve dhe ish-banorëve të fshatit Selcë, Velçan, Mesmal, Të njësisë administrative, Gorë Bashkia Maliq përcjell shqetësimin që ka kanë të gjithë këta banorë lidhur me sigurinë e jetës së tyre në këto zona. Ky shqetësim i theksuar vjen si rrjedhojë e përmbytjeve të ndodhura në datat nëntëmbëdhjetë njëzet e tre nëntor dy mijë e njëzet e pesë nga reshjet e shumta. që kanë rënë në këto ditë, niveli i të cilave ka arritur në katërqind milimetra. Sasi e barazvlefshme me mesataren vjetore në këto zona, pasoja e përmbytjes ka ardhur si shkak e mosveprimit të kompanisë që ka në koncesion, hec kasollet e Selcës nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga ankuesi, i cili është si në format letër, por edhe audioviziv, material i vendosur në dispozicion nëpërmjet një CD-je, evidenton pamje të cilat mund të konsiderohen dëmtime të rënda për të. Ekosistemi i zonës gjithashtu në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Maliç është në rendin e ditës në datën 26 të njëmbëdhjeti është sjellë në vëmendje dhe diskutuar nga anëtarë të këtij këshilli kjo situatë, sikurse në seancën plenare të datës dy të dymbëdhjetë të dy mijë e njëzet e pesë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë është adresuar kjo situatë, si dhe përmendet që ka patur një humbje jetë dhe humbje jetë e njerëzish në këto rrethana, ku banorët e fshatrave të njësisë administrative Gorë ngren zërin për t'u dëgjuar dhe të merren masa për përmirësimin dhe ndalimin e prishjes së mëtejshme të ekosistemit të kësaj zone, e cila po përdoret dhe është dëmtuar nga aktiviteti i shoqërisë që administron veprimtarinë e hecë kasollet e Selcës. Duhet mbajtur në vëmendje se detyrimi i shoqërisë subjektit privat të licencuar për ushtrimin e aktivitetit të marrë në koncesion, të prodhimit të energjisë elektrike me anë të hecë kasollet e Selcës, pavarësisht se në momentet e para që ka nisur ky aktivitet ka bërë investimet fillestare. Kjo nuk do të thotë që të mos ketë të njëjtën vëmendje edhe në ditët e sotme për ruajtjen e ekosistemit të zonës, e cila ndikohet nga aktiviteti që administron. Sa më sipër, institucioni i avokatit të popullit, mbështetur në pikën në nenin trembëdhjetë pika një të ligjit

tetëmijë e katërqind e pesëdhjetë e katër, datë katër i dyti nëntëdhjetë e nëntë për avokatin e popullit të ndryshuar, sipas të cilit avokati i popullit, fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës në bazë të ankesës apo kërkesës së personit të interesuar ose dëmtuar, si dhe me nismën e vet për raste të veçanta. Të bëra publike ka vendosur të fillojë një hetim administrativ për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështje, me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve. Në funksion të shqyrtimit të kësaj çështje, kërkojmë nga ana juaj, si dhe del e nevojshme dërgimi i shpjegimeve të plota dhe detajuar lidhur me a jeni në dijeni me këtë. Të kësaj situate, e cila ka qenë edhe me impakt mediatik, cili është qëndrimi juaj pas mbledhjes datës njëzet e gjashtë nëntor dy mijë e njëzet e pesë të Këshillit Bashkiak? Cili është qëndrimi i Prefektit të Qarkut për fatkeqësitë që ndodhin në familjet e prekura si pasojë e dëmtimit të ekosistemit nga keqpërdorimi i aktivitetit të hecit. Vënien në dispozicion të kontratave të vlefshme të nënshkruara midis bashkisë mali dhe subjektit privat të licencuar për aktivitet të prodhimit të energjisë elektrike me hecin, çfarë çdo informacion dokumentacion që ka të bëjë me këtë çështje. Kjo kërkesë për shpjegime e bazojnë në pikën katër nenit gjashtëdhjetë e tretë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se organet dhe Funksionarët publikë janë detyruar t'i paraqesin avokatit të popullit të gjithë dokumentat dhe informacionin e kërkuar prej tij, si dhe në germën b të nenit nëntëmbëdhjetë, ligji tetëmijë e katërqind e pesëdhjetë e katër, datë katër i dyti nëntëdhjetë e nëntë, për avokatin e popullit të ndryshuar, ku parashikohet se në rast kur vendosen në të kryejë hetime të pavarura, avokati i popullit ka të bëjë me b, të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me këtë hetim. Shpjegimet e kërkuara, lutem na i dërgoni në një kohë sa më të shpejtë të mundshme nga ana juaj, duke ju falenderuar paraprakisht për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin. Kjo ishte kërkesa nga avokati i popullit. Tani jemi tek pika, diskutime ndryshme në qoftë se kemi diçka.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund të them diçka për këtë? Po, nuk e di, është drejtuar këshillit apo dhe administratës?

Ornildi Demollari: Bashkisë Maliq, Këshilli dhe Prefektit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Atëherë ne patjetër jemi detyruar të kthejmë përgjigje për atë çfarë ne kemi për këtë rast. Dua të citoj edhe diçka që nuk ka një kontratë midis bashkisë Maliq dhe kompanisë. Ajo është kontratë koncesionare midis qeverisë, midis ministrisë përkatëse. Ne kemi vetëm një kontratë, që për efekt të kanaleve ku kalon brez pyjorës, ata janë detyruar të paguajnë tek ne sipas tarifave që janë të miratuar me vendim qeverie. Ajo çfarë unë mendoj, megjithëse ajo ka filluar hetim administrativ, ata le të vazhdojnë për ta bërë gjithë dokumentacionin. Të ishte e mundur, megjithëse do të shikoj edhe korrespondencën që ne kemi bërë me avokatët e popullit. Ndoshta mund të jetë një njoftim. Ministrisë përkatëse, Ministrisë së Energjitikës, që është koncesionarja. lidhja e kontratës dhe ndoshta Instituti të të kësaj. Për efekt të rrëshqitjeve, në qoftë se ka për ta parë në vend situatën dhe për t'u shprehur ata, pasi bashkia nuk është se ka specialistë të mirëfilltë për këtë punë, siç patëm rastin e Kakaçit, Vërçunit, që ne.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË SEKRETARIA BASHKIA MALIQ

sollëm një grup, mund të jetë e njëjta gjë për të dhënë një ide, një për të bërë një raport, Gjeologjikë të të mirë të të saktë dhe të mirëfilltë për të parë situatën. Nuk di çfarë mund t'i them tjetër.

Yllson Ibrahimllari: Meqë jemi tek kjo pikë.Vazhdo edhe për mua, ashtu si mërzit. Po, okej, do të flasësh ti, Reisa të flas unë. Të lutem, hajde këtu, se i ndërrojnë vendet. Përderisa u la një mbledhje jashtë radhëve dhe ku do raportohet si është situata, unë besoj që duhet ta zgjidhni ju si këshillë, si kryesi e këshillit që keni afatet ligjore që ju duhen për t'i kthyer përgjigje. Por unë besoj që çdo përgjigje nga ana e këshillit, pa bërë këtë mbledhjen jashtë radhë, do jetë e pakët, jo e plotë dhe tendencioze. Po ju lutem, unë nuk jam nënshkrues atij peticioni. Ju ka ardhur nga avokati i popullit, me sa di unë në dijeninë time, meqë po flasim në Vëlçan nuk ka humbur jetën ndonjë person, ka humbur në jetën në Progër. Ata mund të kenë të dhëna të gabuara, kush i ka nisur, si i ka nisur. Ne kemi një raport tjetër më të thjeshtë, se sakaq nuk kemi vetëm një problem, kemi një problem tjetër, kemi një. Kemi një detyrim ligjor për heqjen nga fondi pyjor kullosor që e ka bashkia me institucionin. Drejtoria pyjore duhet t'i përcaktojë mirë ngastrat ku kalon ajo vijë në kontratën. Në vitin 2026 ata plotësojnë dhe subjektet e tjera plotësojnë. Plotësojnë dhjetëvjeçarin e lidhjes kontratës për informacion për gjithë kolegët. Pjesa tjetër që qëndron është që ai vendim për lidhjen e kontratës zgjidhjen, duke qenë se jemi të dyja palët në bashkëpunim, sigurisht duhet të marrë edhe një miratim të këshillit. Kur të rilidhet, nuk po them ç'a keni trashëguar nga komunat. Është në drejtën tuaj

Ornildi Demollari: Ildir.

Idlir Limllari: Po për rastin në fjalë, mendoj që mund t'i bëhet një kërkesë Inspektratit Kombëtar të Mbrojtjes së Drejtorit dhe të Mjedisit, të cilët mund ta vlerësojnë. Plus që në atë edhe neve informohemi edhe për shkeljet. Është ka shkelja ndotje mjedisore, shkatërrim.

Yllson Ibrahimllari: Idlir, duke qenë se ti je specialist i vetëm nga ne këtu ku jemi, ka një problematikë. Ankesa nuk ka lidhje me problematikat e tjera, qoftë edhe të miat individuale me to. Ankesa e banorëve është përsa i përket problematikës që ka sjellë rruga. Nëse marrim analogjinë me Kakaçin, emergjencat civile janë prononcuar për Kakaçin. Për Gorën nuk ka vajtur askush atje.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Rasti nuk është se aty ka pësuar një rrëshqitje tani. Ky shqetësim është prej kohësh.

Yllson Ibrahimllari:I kujt?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:I strelcës.

Folësi_12: Ju s'po thotë për Strelcën, po flasim për Mesmalin, se Strelca, për kë është ai materiale, për për Velçanin, për mesmalin, për rrugën, për mes.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Për nuk është për Strelcën, po mo, se ka rrezi atë.

Yllson Ibrahimllari: Po, jo, mos e ka Reizi. Dhe më e bukura, kjo është për rrugën. Dhe ndërkohë që të kuptojmë tjetër, as nuk është, nuk është, as përmbytjen time. Yllson, është vetëm për rrugën nga banorët.

Ornildi Demollari: Yllson, e morëm kërkesën. Do ta, do respektojmë afatet.

Yllson Ibrahimllari: Ore, pse bën kirurgji vetëm me mua ti?

Ornildi Demollari: Jo, të lutem, se duhet të vazhdojmë.E po çoje dhe shikoje, ta shikosh si.

Ornildi Demollari: Si urdhëron? Si urdhëron? Faleminderit.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Unë mendoj, bëheni pjesë, o doktor, doktor. Ornild, unë mendoj që bëheni pjesë të takimit. Të mbledhjes do bëni për përmbytjen.

Ornildi Demollari: Kemi dhe tre qytetarë këtu, ju lutem zotërinj. Zotërinj, ju në fund aty me radhë, jo, jo, ai tjetri, ai tjetri, ai tjetri. Ulu, ulu, ta dëgjojmë këtë. Ulu, edhe ai më është varësi i tjetrit.

Qytetari:Të nderuar këshilltar, i nderuar kryetar, gëzuar vitin dy mijë e njëzet e gjashtë të gjetheve. Quhem Xhevit Biba nga Çaushlia. Kam një problem super shqetësues që po bëj ç'është e mundur prej tre vjetësh dhe nuk gjej asnjë farë rrugëzgjidhje, vetëm sorollatje, gënjeshtra dhe mashtrime. Kam trembëdhjetë vjet që kam ardhur këtu, edhe unë kam skicën e shtëpisë, e cila është bllokuar. Me imtësinë më të hollë dhe shumë herë e ka parë zoti kryetar të bllokuar rrugën me të dy krahët, si nga ana e Kakaçit dhe nga pjesa e hyrjes. Edhe rruga është e bllokuar, në xhadeja. Mune shpija ime u bë një pritë kështu, pastaj u bë një ndërtesë, e cila është lejuar nga shteti. Po s'deshi askush, nuk bën vaki që të bëjë dhe një karrocë çimento, sepse e dënon policia dhe jo të bëjë një ndërtesë. Kam shkuar. në në një rrugë qorre me terra, e cila këmbësorçe. Që më bënte rezil dhe komshia përpara, që mos shko rrugës treqind metra a katërqind metra larg, po shko këtu tridhjetë dhe njëzet metra. Kam shkuar aty prej dy-tre vjetësh, edhe nuk i kam hyrë atij avazi që bllokimi që më është bërë nuk e kam kërkuar. Që t'i futem për fat të keq. U hëngrëm me një komshi aty, i cili është ngrënë po dhe me kryetarin. Prezent që ka qënë, që e ka parë me hollësi. Dhe i ka thënë ai komshija që është si mbreti i asaj lagje që neve ose na trajtojnë si armiq atje. I ka thënë zoti kryetar dhe ia thanë në sy që këtu nuk ka rrugë këmbësor që tha. Arsyeja tha se ka qënë trua dhe ka blerë tjetri katër milionë e gjysmë lekë. Në një kohë që ky që e ka atë pjesë toke, aty që i ka leju këmbësorçe, kam pasur një. Bëj unë, ana tjetër. Unë tashi mbas bllokimit që është bërë të rrugës këtu, tashti janë fotot, ja si është rruga ime. Janë në dy rrugët të bllokuara, këtu ku shkon një?

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu: Mund ta shikoj këtë situate? Që ta kuptojnë.

Ornildi Demollari: Zotëri, më fal, më fal dhe vazhdo prapë. Ta mbaroj, ja më dëgjo një moment dhe vazhdo. Kryetari e njeh situatën. A mund të shpjegojë diçka? Kryetari, apo ke nevojë akoma?

Qytetari: Ta mbaroj edhe këtë.Mua nuk më linte drejta të bëj kërkesën për verifikimin e rrugës të vijë komisionit ta shikojë pa mos paguar dhe qindarkën. E pagesa me qënë takon si gjithë të tjerë, pa diskutim e kemi bërë. I kemi paguar tarifat që duhen paguar si gjithë të tjerë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:E ke Tapinë?

Qyetari:Këtë nuk e kanë dhënë falje, pse nuk e dini, po e kam, qind për qind, ashtu i ka bërë kërkesë.

Kryetari i Bashkisë;z.Gëzim Topçiu:Do e shikojmë problemin tuaj.

Ornildi Demollari: Kemi dhe qytetarin tjetër.

Qyetari:Të më kthehet përgjigje për kërkesën që kam bërë.

Ornildi Demollari: Po patjetër do e shohim, por në adresën e Këshillit nuk ka erdhur kjo kërkesë.Kemi diçka tjetër? Kjo ishe mbledhja për sot.Faleminderit! Gëzuar.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI